

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Brunilda Bekteshi, kam votuar kundër vendimit të shkarkimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala, me funksion prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas mendimit të pakicës, arriti nivel të besueshëm edhe në rivlerësimin e pasurisë, ndërsa, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, që nuk do të analizohen në vijim, bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues të shprehur në vendim, pasi nuk janë evidentuar/konkluduar problematika.

1.1 Më poshtë rendis arsyet e votës kundër, duke u ndalur dhe arsyetuar qëndrimet e mia kundër konkluzioneve që ka mbajtur shumica e trupit gjykues në këtë çështje, ku nën analizën e provave të administruara, më kanë çuar në formimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në drejtim të vlerësimit të kontrollit të pasurisë dhe, për pasojë, ky kriter i procesit të rivlerësimit për të duhej të vlerësohej në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) dhe duhej konsideruar së bashku me vlerësimin në nivel të besueshëm e të përshtatshëm për të dyja kriteret e tjera, atë të figurës dhe të aftësive profesionale, për të cilin edhe shumica ndan të njëjtin qëndrim, se subjekti duhej konfirmuar në detyrë, pasi në mënyrë kumulative plotësonte të tria kushtet e parashikuara prej nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave vendoset konfirmimi në detyrë për subjektet e rivlerësimit.

1.2 Ndryshe nga shumica e trupit gjykues kam arritur në një konkluzion tjetër për sa i përket vlerësimit të mjaftueshmërisë së deklarimeve dhe burimeve të ligjshme të përdorura prej subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz C220 CDI”, viti i prodhimit 2003, blerë në datën 7.2.2009, në shumën 11.390 euro, i targuar me targa ***.

1.3 Për këtë pasuri, Komisioni në rezultatet e hetimit i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me konstatimet se: (a) dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë, pasi nuk kishte deklaruar detyrimin doganor të paguar për automjetin në vlerën 478.502 lekë, as në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit 2009; (b) dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kur deklaronte kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, pasi depozita në shumën 5.000 USD ishte çelur përpara se subjekti të fillonte studimet.

1.4 Në zbatim të parashikimit të bërë në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, *objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyrë e trupit gjykues është verifikimi i deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe, pas një leximi të saktë dhe korrekt të këtyre deklarimeve, të kontrollohet nëse subjekti ka pasur mundësi që me burime të ligjshme të ketë krijuar pasurinë e deklaruar.*

1.5 Mbi këtë parashikim ligjor kam çmuar se kuptimi i qartë i deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe, më pas, verifikimi i vërtetësisë së këtij deklarimi duhet të kryhet përmes të gjitha fakteve që burojnë të evidentuara nga burimet e njohura të provës, sipas përkufizimeve të ligjit nr. 84/2016, posaçërisht parashikimit të neneve 32/5 dhe 49 të tij.

1.6 Në funksion të shpjegimeve, për këtë deklarim, përgjatë procesit të rivlerësimit subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala ka shpjeguar se: *“Detyrimi doganor i paguar për automjetin tim në vlerën 478.502 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë nuk është pasqyruar prej meje për t’i qëndruar korrekt kërkesave që paraqiteshin në formatin e deklaratës periodike vjetore të deklarimit të pasurisë për vitin 2009, kur është bërë deklarimi për herë të parë i*

automjetit. Në këtë deklaratë kërkohej deklarimi i shpenzimeve në shumën mbi 500.000 lekë, ndërkohë që shpenzimi për doganën ka qenë më pak se kjo vlerë. Ndërkohë nga ana ime është deklaruar se për blerjen e automjetit në vlerën 11.300 (njëmbëdhjetë mijë e treqind) euro si dhe shpenzimin për pagesën e detyrimit doganor në vlerën 478.502 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë, janë përdorur, shumat 800.000 (tetëqind mijë) lekë hua e dhënë nga familjarët e mi, familja e hallës (e deklaruar nga bashkëshorti i saj V.L), si dhe të ardhura nga kursimet nga paga si dhe depozitat bankare prej 5.000 (pesëmijë) USD dhe 300.000 (treqind mije lekë). Duke mbledhur shumat e mësipërme pra depozitat, të ardhurat nga paga, si dhe huan prej 800.000 lekësh, në këtë vlerë përfshihet i gjithë shpenzimi si për blerjen e automjetit ashtu edhe shpenzimi për detyrimin doganor”.

1.7 Në referim të pretendimeve të subjektit, lidhur me mosdeklarimin e detyrimit doganor të paguar për automjetin, kam konstatuar se bazuar në nenin 4 “Afati dhe objekti i deklarimit” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në fuqi në vitin e deklarimit për herë të parë të kësaj pasurie, nuk parashikohej detyrimi i deklarimit të shpenzimeve, pasi ky detyrim është përfshirë për herë të parë në ligjin nr. 85/2012, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, ku me nenin 3 (në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003) është shtuar germa “h” me përmbajtje: “Çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit”.

1.8 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kur subjekti deklaroi kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, pasi depozita në shumën 5.000 USD është çelur përpara se subjekti të fillonte shkollën, ka parashtruar dhe mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe në deklaratimet e dhëna më parë gjatë hetimit administrativ se deri në vitin 2012, kohë kur ka filluar bashkëjetesën me bashkëshortin, ekonomia ka qenë e përbashkët me familjen e origjinës, prindërit dhe motrat. Subjekti ka sqaruar se në qershor të vitit 2006, babai i saj për arsye pune ka udhëtuar drejt SHBA-së për një kurs/trajnim 6-mujor. Pasi është larguar drejt SHBA-së është menduar që një pjesë të kursimeve të prindërve të depozitoheshin në bankë në një llogari në emrin e saj në mënyrë që në rast të një situatë apo nevojë për likuiditete gjatë qëndrimit të babait në SHBA kjo shumë t’i transferohej menjëherë. Subjekti ka deklaruar se: “Në muajin tetor të vitit 2006, unë kisha filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe po paguhesha me bursë dhe kur babai im u kthye në Shqipëri me përfundimin e kursit në muajin dhjetor të vitit 2006, prej prindërve të mi u çmua e panevojshme mbyllja e kësaj llogarie, por duke qenë se unë ndërkohë kisha filluar të gjeneroja të ardhura, u sugjerua mbajtja e kësaj llogarie nga unë dhe, ndërkohë unë po dorëzoja në familje një shumë të konsiderueshme nga bursa që merrja në Shkollën e Magjistraturës. Në këto kushte nga ana ime shuma e depozituar në këtë llogari në momentin e deklarimit të parë në momentin e fillimit të detyrës është konsideruar si kursim nga të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës”. Subjekti në mbështetje të pretendimeve të saj ka depozituar disa dokumente¹.

1.9 Në analizë të të gjitha të dhënave që vijnë nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ dhe vlerësimit të tyre në raport me njëra-tjetrën, në funksion të përcaktimit të vlerës provuese të secilës provë dhe krijimit të bindjes së brendshme, kam arritur në konkluzionin se deklaratimet e subjektit për kronologjinë e fakteve, sipas shpjegimeve të dhëna

¹Një kopje të urdhërit nr. ***, datë 18.4.2006, “Për dërgim me studime jashtë shtetit”; kontratë nr. *** prot., datë 6.6.2006, “Për arsimim dhe kualifikim brenda e jashtë vendit të ushtarakëve e aktivë”, për periudhën 14.6.2006 – 9.12.2006.

prej saj edhe në eventualitetin e një pasaktësie, kur kjo e fundit nuk shoqërohet me mungesë burimesh, nuk mund të kualifikohet si shkak më vete për penalizimin e subjektit.

1.10 Për të arritur në këtë konkluzion, në kuptim edhe të parashikimit të pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes*, kam kryer vlerësimin e dy elementeve përbërës të kriterit të pasurisë, lidhur me vërtetësinë e deklarimeve dhe verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie referuar dhe pikës 4, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës.

1.10.i Lidhur me çmuarjen e vërtetësisë së deklarimeve, vlen të analizohen deklaratimet e subjektit për këtë pasuri, për të cilën qëndrojnë faktet e renditura në vijim:

a. Ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DPV-në e vitit 2009, me përshkrimin: *“Automjet tip ‘Mercedes-Benz C220’. Viti i prodhimit shkurt 2003. Blerë në shkurt 2009 me anë të depozitave të mia bankare në shumat 5.000 USD dhe 300.000 lekë. Vlera 11.300 euro. Pjesa takuese: 100%”*.

b. Ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pakësim të depozitave të saj, përkatësisht në vlerën 5.000 USD, në “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe vlerën 300.000 lekë në “ProCredit Bank”. Gjithashtu, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë”, subjekti ka deklaruar: *“Detyrim në lekë në vlerën 800.000 lekë për blerjen e makinës nga familjarë. Data e fillimit të detyrimit shkurt 2009. Shuma e shlyer deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklaratimit 300.000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer 500.000 lekë”*.

c. Për këtë pasuri, sipas dokumentacionit të dërguar në Komision nga DPSHTRR, është konstatuar se mjeti është blerë në datën 7.2.2009, në vlerën 11.390 euro. Referuar deklaratës doganore, datë 12.2.2009, subjekti ka paguar vlerën 478.502 lekë, si detyrim doganor (TVSH), për zhdoganimin e këtij mjeti, shumë kjo që nuk ishte deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën periodike dhe as në deklaratën *Vetting*.

1.10.ii Lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, qëndrojnë faktet e renditura në vijim:

a. Për burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit “kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, shuma prej 301.000 lekë”, nga hetimi është provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në Shkollën e Magjistraturës në tetor të vitit 2006, ku dhe është trajtuar me bursë gjatë kësaj periudhe dhe në datën 27.12.2006 ka çelur depozitë në vlerën 120.000 lekë. Rezultoi se subjekti, më pas, ka kryer depozitime për çdo vit duke e mbyllur (tërhequr) depozitën në datën 28.3.2009, në vlerën 309.579,19 lekë, së bashku me interesat përkatëse të përfituara. Në analizë të këtyre fakteve, rezulton se subjekti ka kryer deklaratim të saktë për këtë burim.

b. Në lidhje me kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës në shumën 5.000 USD, të depozituara në bankë, nga faktet e dala gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në Shkollën e Magjistraturës për periudhën tetor 2006 –2008 dhe është trajtuar me bursë gjatë kësaj periudhe.

c. Nga analizimi i dokumentacionit bankar në “ProCredit Bank”² u konstatua se subjekti ka çelur në datën 13.7.2006 një depozitë në valutë në vlerën 5.000 USD. Kjo depozitë rezultoi se ishte mbyllur në datën 13.9.2008 dhe kjo shumë ishte depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”³

²Shkresë nr. prot.: OP-***, datë 14.5.2020.

³Shkresë nr. *** prot., datë 19.5.2020.

në datën 17.9.2008. Subjekti e ka tërhequr depozitën së bashku me interesat e përfituara në vlerën 5.065,85 USD, në datën 24.9.2009.

ç. Nisur nga fakti i konstatimit se depozita ishte tërhequr 7 muaj më vonë nga data e blerjes së automjetit, çmuj se deklarimi i subjektit se... *burim për blerjen e këtij automjeti janë pikërisht ato që kam deklaruar dhe më parë, por për shkak se kursimet e mia ndodheshin të depozituara në bankë dhe në mënyrë që mos të penalizohesha për tërheqjen e këtyre depozitave nga banka përpara datës së maturimit jam ndihmuar për një afat të shkurtër kohe deri në maturimin e depozitave nga prindërit e mi. Këtë ndihmë nuk e kam paraqitur në deklaratën periodike të deklarimit të pasurisë të vitit 2009, pasi veprimi është kryer dhe përfunduar brenda vitit 2009, pra, brenda të njëjtës periudhë deklarimi. Ndërkohë që kam deklaruar ndryshimet e ndodhura në periudhën midis deklarimeve, duke sqaruar faktin se janë pakësuar dy depozitat e mia të cilat janë përdorur për blerjen e automjetit, si dhe huaja ndaj familjes së hallës sime e cila vazhdonte të mos ishte shlyer ende në vitin pasardhës, duhet të vlerësohet në raport me vlerësimin e burimeve të ligjshme të prindërve të saj.*

1.11 Në këtë drejtim rezultoi e provuar se: (a) babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi B.B, ka qenë në marrëdhënie pune pa ndërprerje që prej datës 1.9.1978 në disa pozicione të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes (Forcat e Armatosura, ***, etj.); (b) nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja V.B, ka qenë në marrëdhënie pune pa ndërprerje që prej datës 21.4.1981 dhe deri në momentin e daljes në pension në gusht të vitit 2020, në disa pozicione të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes (***); (c) motra e subjektit të rivlerësimit, shtetasja E.B, ka qenë në marrëdhënie pune⁴ pa ndërprerje që prej datës 5.12.2008 deri në nëntor të vitit 2014; (ç) investimet e kryera nga prindërit e subjektit konsistojnë vetëm në blerjen e një apartamenti të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave⁵ dhe një automjet⁶ të blerë në vitin 2008 nga babai; (d) në “Tirana Bank”⁷, babai i subjektit, shtetasi B.B, ka çelur në datën 16.6.2003 depozitë në vlerën 6.600 USD; (dh) në “ProCredit Bank”⁸, nëna e subjektit, shtetasja V.B, ka çelur në datën 19.1.2006 depozitë në vlerën 1.310.000 lekë (kjo shumë vjen si rezultat i tërheqjes së depozitës në “Raiffeisen Bank”⁹) dhe në datën 13.7.2006 depozitë në vlerën 10.000 USD; (e) babai i saj, shtetasi B.B, ka tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” në datën 22.8.2008, shumën 1.137.000 lekë¹⁰ (sipas subjektit mbajtur gjendje *cash* prej tij në banesë).

1.12 Mbi këto të dhëna të verifikuara, lehtësisht konstatohet se të ardhurat e prindërve të subjektit, të krijuara vetëm nga pagat e evidentuara në bankë, për periudhën 2006 – shkurt 2009, kanë qenë në vlerën 4.246.211 lekë.

1.13 Edhe nga analizimi i dokumentacionit të administruar, nën shtrirjen e një analize financiare të familjes së origjinës së subjektit, për vitet 1993 – 2008, rezultoi se: (a) ISSh-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror, ka vërtetuar se shtetasi B.B (babai i subjektit), për periudhat tetor 1993 – shtator 2000n dhe janar 2001 – dhjetor 2004, ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur edhe kontributi; (b) punëdhënësi Ministria e Mbrojtjes, me vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* ka konfirmuar faktin se shtetasja V.B (nëna e subjektit), për periudhat qershor 1993 – tetor 1993, shtator 1995 – shtator 2000 dhe janar 2003 – gusht 2003, ka përfituar pagesë transferte si bashkëshorte e ushtarakut, z. B.B; (c) ISSh-ja, me dokumentin/vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* me punëdhënësin Reparti

⁴Sipas librezës së punësimit.

⁵Kontratë shitje apartamenti nr. ***, datë 11.6.2008, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri, si finalizim i kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 13.5.2002.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga DPSHTRr-ja. Mjeti i blerë në vlerën 3.900 euro dhe TVSH në doganë në vlerën 304.906 lekë.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 15.5.2020.

⁸Shkresë nr. prot.: OP-***, datë 14.5.2020.

⁹E cila figuron që prej vitit 2005.

¹⁰Konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020.

Usharak ***, ka konfirmuar faktin se për periudhën 1.9.2003 – 31.5.2007, nëna e subjektit ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur edhe kontributi përkatës; (ç) me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.1993, të Ministrisë së Mbrojtjes, konfirmohet fakti se shtetasja V.B, ka përfutur një shtesë mbi pagë, si bashkëshorte e ushtarakut.

1.14 Nga verifikimi i të ardhurave, sipas dokumentacionit të sipërcituar, ku konfirmohen të ardhurat e ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga Njësia e Shërbimit Ligjor, pas përlllogaritjeve të kryera (shihni tabelën nr. 1, referuar më poshtë), në raport me të ardhurat dhe shpenzimet për vitet 1993 –2008 për të gjithë familjen prej 5 anëtarësh, është konstatuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare të kontribuojnë në krijimin e kursimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe ta ndihmojnë atë në blerjen e automjetit, përpara tërheqjes së depozitave nga ana e saj.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	1993 – 2008
1	Të ardhura	13,570,647
	Të ardhura nga punësimi babai	9,036,781
	Të ardhura nga punësimi nëna	1,639,215
	Të ardhura nga punësimi subjekti	1,092,534
	Hua nga shtetasi V.L	1,500,000
	Të ardhura nga interesat	302,117
2	Shpenzime	5,991,157
	Shpenzime jetese ¹¹	5,991,157
3	Pasuri	6,025,567
	Automjet në pronësi të babait	785,318
	Apartament banimi	860,915
	Likuiditete në bankë	3,242,334
	Likuiditete <i>cash</i>	1,137,000
	Mundësia për kursim (1-2-3)	1,553,923

1.15 Lidhur me konkluzionin për mosdeklarimin e saktë të burimeve të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, vlerësoj se kjo pasaktësi nuk mund të penalizojë subjektin për sa kohë është provuar (pranuar edhe nga vetë shumica) që burimet e deklaruara prej saj janë të ligjshme dhe të mjaftueshme. Arrij në këtë konkluzion duke mbajtur parasysh: (i) lidhjen e afërt midis subjektit, familjes së saj dhe të afërmeve të saj; (ii) faktin që në periudhën e krijimit të depozitave subjekti banonte në familjen e saj të origjinës; (iii) faktin që të ardhurat e prindërve dhe të afërmit të saj (shtetasit V.L) ishin më se të mjaftueshme dhe të krijuara në mënyrë/me burime të ligjshme dhe, konkretisht, nga marrëdhëniet e punës (sa i përket prindërve), si dhe nga marrëdhëniet e biznesit dhe shitjes së pasurisë së paluajtshme (sa i përket shtetasit V.L).

1.16 Në vlerësimin tim, qëndrimi i mbajtur nga shumica për pasurinë e parë, në pikën 21.2. ... ku thuhet “Por, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, pasaktësitë janë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit, duke u vlerësuar në raport me disa rrethana të tjera të

¹¹Për vitet 1993-1999 shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 66% e të ardhurave. Ndërsa për vitet 2000-2003 është marrë e njëjta vlerë si ajo e vitit 2003 sipas shkresës nr. ***prot., datë 4.3.2019, së ILDKPKI-së, për 5 persona sipas përbërjes familjare.

evidentuara gjatë hetimit administrativ si vijojnë: “(iii) faktit që në mënyrë të përsëritur subjekti deklaroi se si burim për blerjen e pasurive gjatë periudhës që ka qenë në detyrë, kanë shërbyer vlera monetare të cilat nuk i ka pasur në momentin e blerjes së pasurive (trajtuar hollësisht në vijim), për të cilat, po në mënyrë të përsëritur, gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se i ka marrë në formë huaje a dhurimesh nga persona të tretë”, duket tërësisht paragjykes, pasi përfundimet nuk janë rrjedhojë e çmuarjes së drejtë të fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm. Referuar argumenteve të paraqitura në analizën e shumicës, mbahet një qëndrim kontradiktor dhe jo i arsyetuar, pasi shumica nga njëra anë pranon se këto pasaktësi në vetvete mund të mos kenë një peshë specifike të posaçme, sepse rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur mjaftueshëm të ardhura dhe nga ana tjetër synon apo merr në konsideratë këtë pasaktësi duke ia veshur subjektit në vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë.

1.17 Po ashtu konstatimi i shumicës¹² se subjekti mungon të ketë kryer deklarime, në lidhje me të ardhurat e prindërve të saj, në deklaratën Vetting, duke e kualifikuar si pasaktësi në vlerësimin tërësor, në gjykimin tim, nuk qëndron për disa fakte të qenësishme, si në vijim:

- i) burimet e krijimit të kësaj pasurie rezultuan të ligjshme dhe të mjaftueshme;
- ii) veprimet e zëvendësimit të burimeve të krijimit të depozitës në vlerën 5.000 USD, rezultuan të kryera brenda vitit;
- iii) veprimet janë kryer në kohën kur subjekti nuk ka qenë në detyrë, por ka qenë në një ekonomi të përbashkët familjare;
- iv) deklarimi i burimit si ai i momentit të pagesës (sipas shumicës) dhe ai fundor sipas subjektit rezultoi i ligjshëm.

1.18 Nën këtë arsyetim, logjikisht dhe ligjërisht bindës, kualifikimi për një deklaram të pasaktë, nuk ka peshë të tillë që mund të shërbejë si shkak për cenimin e nivelit të besueshmërisë në rivlerësimin e pasurisë, apo procesit të rivlerësimit në tërësi për këtë subjekt.

2. Ndryshe nga shumica e trupit gjykes kam arritur në një konkluzion tjetër për sa i përket vlerësimit për vërtetësinë e deklarimeve dhe burimeve të ligjshme të përdorura prej subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë apartament me sip. 91.09 m², ndodhur në ***, Tiranë, i blerë në shumën 48.000 euro me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 28.1.2015, në bashkëpronësi me bashkëshortin, shtetasin GJ.N.

2.1 Analiza dhe arsyetimi i shumicës për këtë pasuri rezultoi e fokusuar në elementet e barrës së provës, që i është kaluar subjektit të rivlerësimit pasi: (i) dukej se nuk provohej vlera reale e të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i gjyshërve të subjektit, të ardhura këto të përdorura si burim për krijimin e shumës së dhuruar prej tyre; (ii) dukej se nuk provohej vlera reale e fitimit të realizuar nga aktiviteti i blegtorisë, nga babai i bashkëshortit të subjektit, të ardhura këto të përdorura si burim për krijimin e shumës së dhuruar; (iii) dukej se subjekti gjendej në pamundësi financiare në vlerën 8.994.151 lekë për të paguar këstet e kësaj pasurie, dy pagesat në vlerën 48.000 euro në Bankën Kombëtare Tregtare (këtu e në vijim BKT), si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (iv) dukej se kishte paqartësi për Komisionin kryerja e pagesave në bankë, si dhe mbetej i dyshimtë qëllimi dhe destinacioni real i tyre.

2.2 Mbi të gjitha çështjet e renditura në pikën 2.1 (të kësaj pakice), kam ndarë mendim ndryshe nga shumica, pasi kam vlerësuar se nga ana e tyre/shumica nuk është bërë një analizë e qartë dhe, për rrjedhojë, as edhe një vlerësim i drejtë i provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm nr. 84/2016.

2.3 Për sa më sipër, lidhur me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e shumës 1.000.000 lekë, dhuruar subjektit të rivlerësimit nga gjyshërit Z dhe H.B edhe pse ndaj të njëjtin mendim si shumica sa

¹² Referojuni pikës 21/2/ii në vendim.

i takon konkluzionit përfundimtar se *gjyshërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë në vitin 2011*, çmuj që ky konkluzion duhet arsyetuar dhe qartësuar në raport me konfondimin që bën shumica (referuar në përmbajtje të pikës 30) kur shprehet se *...subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për shkaqe objektive dhe ligjore për të vërtetuar të ardhura konkrete dhe pagimin e tatimit mbi këto të ardhura*, ndërkohë që subjekti në këtë drejtim ka pretenduar se e ardhura që i takon aktivitetit bujqësor e blegtoral nuk i nënshtrohet tatimit.

2.4 Nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një dhurim të përdorur si një prej burimeve të blerjes së pasurisë apartament banimi me sip. 91.09 m², fillimisht, çmuj se në këtë çështje objekt vlerësimi, duhet të arsyetohen dy kërkesat që kërkon pika 1, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”* dhe pika 4, ku përcaktohet: *“... subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

2.5 Lidhur me vërtetësinë e deklarimeve, duke e gërshetuar këtë edhe me konfirmimin e marrëdhënies së dhurimit, hetimi administrativ nxori në pah fakte të tilla, mbi të cilat ka rezultuar se:

2.5.i Subjekti këtë dhurim e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* me përshkrimin *... shuma 1.000.000 lekë dhuratë nga gjyshërit Z dhe H.B, me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 25.11.2011, shumë e tërhequr nga llogaria e hapur prej tyre më 19.1.2006, në Bankën e Shqipërisë*. Po ashtu, ka rezultuar se këtë dhurim subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë për vitin 2011 me përshkrimin *dhuratë nga gjyshërit e mi me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 25.11.2011. Vlera: 1.000.000 lekë*. Të njëjtin deklaram¹³ subjekti e ka bërë edhe përgjatë procesit të rivlerësimit të saj.

2.5.ii Në analizë të deklarimeve dhe provës së administruar/kontratë dhurimi, evidentohen dhe provohen dy të dhëna; (a) subjekti e ka deklaruar në DPV-të këtë dhurim në kohën që është marrë si dhuratë; (b) kjo marrëdhënie konfirmohet mes palëve para noterit, po në kohë reale, çka provon faktin se vullneti i palëve për këtë dhurim ka qenë real dhe i pakontestuar. Një tjetër element, që më përforcon bindjen mbi vërtetësinë e këtij dhurimi, është edhe lidhja e ngushtë familjare midis dhuruesve dhe subjektit. Nën këtë analizë të fakteve dhe provave gjykoj se subjekti ka deklaruar me vërtetësi këtë dhurim të përdorur si burim krijimi të pasurisë në fjalë.

2.5.iii Lidhur me ligjshmërinë e shumës së dhuruar, kam vlerësuar së në këtë çështje duhet të bëhet çmuarja e provave dhe fakteve të dala nga hetimi dhe gjithë procesit në tërësi, i cili ka provuar këto fakte:

a. Rezultoi e provuar se shuma e dhuruar ka qenë e depozituar në bankë nga gjyshërit e subjektit shumë kohë përpara kryerjes së dhurimit. Në funksion të provueshmërisë së këtij dhurimi, konstatohet se është vërtetuar me dokumentacion origjina e këtyre shumave, si dhe lëvizjet bankare. Në analizë të fakteve të dala nga provat, lehtësisht u vërejt se: (i) me dokumentin/kartelën e klientit H.B, pranë Bankës së Shqipërisë, vërtetohet krijimi shumë kohë më parë i shumës 1 650.917 lekë. Kjo shumë është tërhequr në datën 4.2.2011 dhe, prej saj, vlera 1.000.000 lekë i është dhuruar subjektit të rivlerësimit; (ii) me vërtetimin, datë 25.1.2016, të Bankës së Shqipërisë, dega ***, konfirmohet fakti se shtetasja H.B (gjyshja e subjektit) ka hapur llogari pranë Bankës së Shqipërisë ****, bono thesari të tregtueshme dhe të likuidueshme, të emetuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë që prej datës 19.1.2006 dhe

¹³Me pyetësorët nr. 1, datë 9.1.2020, nr. 2, datë 6.12.2021 dhe parashtrimet e subjektit datë 30.3.2022.

në vazhdimësi; (iii) nga institucioni bankar, “Raiffeisen Bank” konfirmohet fakti se gjyshërit e subjektit kanë pasur llogari dyemërore dhe figurojnë me depozitë në vlerën 1.439.000 lekë që prej vitit 2004, shumë kjo që së bashku me interesat e përfituara, është investuar bono thesari, që në datën 31.1.2006, në vlerën 1.800.000 lekë; (iv) subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 1.200.000 lekë, datë 19.12.2011, në “Credins Bank”.

b. Nga analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, vlerësoj se merr rëndësi fakti i të provuarit se të ardhurat e gjyshërve kanë qenë të formalizuara, të depozituara në sistemin bankar shumë vite përpara se të kryhej akti i dhurimit dhe emërimit të subjektit në detyrë, çka mbështet vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të përdorura si burim për blerjen e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

2.6 Në lidhje me analizën e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga pensioni i gjyshërve të subjektit të rivlerësimit, ISSh-ja¹⁴ ka konfirmuar se shtetasi Z.B nga marsi i vitit 1992 ka përfutuar pension pleqërie, ndërsa shtetasja H.B ka përfutuar pension pleqërie nga tetori i vitit 1994. Instituti i Sigurimeve Shoqërore¹⁵, Drejtoria Rajonale Gjirokastër ka konfirmuar faktin se të ardhurat e përfituara për periudhën 1991 – 2006 nga gjyshërit e subjektit janë në vlerën 1.057.695 lekë, të ardhura këto që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe masën e shumës së dhuruar. Kam vlerësuar se këto të ardhura duhet të përlllogariten deri në vitin 2006, pavarësisht se ato vërtetohen edhe pas vitit 2006¹⁶, pasi në këtë vit është kryer investimi në bono thesari dhe dhurimi ndaj subjektit ka si burim tërheqjen nga bonot e thesarit. Pra, duke i qëndruar vetëm të ardhurave të siguruara nga pensioni i gjyshërve të subjektit, plotësohet shuma e dhuruar prej 1.000.000 lekësh.

2.7 Në lidhje me analizën e provave mbi të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i gjyshes së subjektit të rivlerësimit, rezultoi e provuar se ka ushtruar aktivitet tregtar që prej vitit 1993, provuar kjo nëpërmjet: (i) kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 14.1.1994, për blerjen e njësisë së shitjes ushqimore (dyqan i përzier) me sip. 99 m², nga H.B ndaj ***, në vlerën 72.719 lekë për ndërtesën dhe vlerën 16.790 lekë për truallin mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa; (ii) lejes së ushtrimit të aktivitetit privat tregti mallrash të ndryshëm në njësi, me datë lëshimi 2.2.1993, në emër të shtetasës H.B; (iii) shkresës nr. *** prot., datë 28.3.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, ku ka rezultuar e provuar se gjyshja e subjektit H.B, ka ushtruar aktivitet tregtar me Nr. Leje ***, me objekt “Tregti të mallrave të ndryshëm në njësi” prej vitit 1993. Gjithashtu, subjekti ka depozituar korrespondencën¹⁷ e mbajtur nga gjyshja e saj me DRT-në Gjirokastër, nga verifikimi i të cilës provohet fakti se shtetasja H.B është e pajisur me leje të ushtrimit të aktivitetit “***, në njësi me adresë, ***, Gjirokastër, me kod fiskal ***”, ndërsa konfirmohet se nga ky institucion është e pamundur të vërtetohet fakti se sa ka qenë shuma e tatimeve të paguara për këtë aktivitet.

2.8 Sa më sipër konstatuar, fakti që nga njëra anë Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër ka shprehur pamundësinë për të provuar shumën e tatimeve dhe nga ana tjetër ka konfirmuar se shtetasja H.B nuk rezulton të jetë debitore, çmohet si tregues në krijimin e bindjes së brendshme se gjyshja e subjektit ka ushtruar këtë aktivitet, ka përfutuar realisht të ardhura, dhe se mungesa e informacionit nga institucioni nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit. Në këtë drejtim, pavarësisht rrethanave të paraqitura, për sa kohë, subjekti ka provuar bindshëm të ardhurat e tjera të përfituara prej tyre, si nga aktiviteti i bletërritësve dhe nga ai i produkteve bujqësore, për të cilët arsyetohet më poshtë, të çmuara në tërësi më kanë çuar në konkluzionin se

¹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2021.

¹⁵Referojuni vërtetimeve nr. *** prot., datë 24.3.2022 dhe nr. *** prot., datë 24.3.2022.

¹⁶Pasi rezulton se deri në nëntor të vitit 2011, kur është dhuruar shuma 1.000.000 lekë, rezulton se gjyshërit kanë marrë shumën 2.155.944 lekë të ardhura nga pensioni.

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2022.

subjekti ka shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e shumës së dhuruar nga gjyshërit në masën 1.000.000 lekë.

2.9 Lidhur me provueshmërinë e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i bletërritjes, i ushtruar nga gjyshi i subjektit, kanë rezultuar të provuara faktet: (i) shtetasi Z.B ka qenë i regjistruar¹⁸ si fermer shumë më herët, pasi rezulton në regjistrat fizikë që në vitin 2000. Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë ka informuar edhe mbi përfitimin e mundshëm që mund të realizohet nga një fermë me 51 koshere, ku vërtetohet se përfitimi nga parku prej 51 koshere do të ishte rreth 408,000 lekë në vit; (ii) fermeri¹⁹ Z.R.B rezultoi i regjistruar në sistemin “***”, prej vitit 2011, me kodin e fermës *** si bletërritës me 51 koshere; (iii) Shoqata e Bletërritësve të Shqipërisë²⁰ ka konfirmuar se fitimi *neto* i mundshëm për një koshere për prodhim mjalti është parashikuar në vlerën 22.000 lekë/koshere në vit dhe, po ashtu, edhe për prodhim qumësht blete është parashikuar një vlerë relativisht e konsiderueshme 128.000 lekë/koshere në vit.

2.10 Referuar këtyre provave konstatohet se vetëm duke pasur parasysh vlerën minimale të fitimit të llogaritur nga ana Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, shuma prej 1.000.000 lekësh e dhuruar do të ishte e mundur të sigurohej si fitim vetëm nga parku i bletëve, ku në këto përlllogaritje është llogaritur vetëm fitimi nga prodhimi i mjaltit dhe jo fitimi nga prodhimi i qumështit të bletës.

2.11 Po lidhur me provueshmërinë e ligjëritimit të të ardhurave të përfituara nga ky aktivitet, subjekti ka deklaruar: *“Duke qenë se prodhimi është artizanal dhe fermerët përjashtohen nga detyrimi për të deklaruar fitimin dhe të tatonen, është e pamundur që të disponohen fatura të shitjes së mjaltit dhe qumështit të bletës pasi ai shitet tek të njohurit e familjarëve dhe nuk disponohen fatura shitjeje, pasi fermerët sipas legjislacionit në fuqi përjashtohen nga detyrimi tatimor”*. Gjithashtu, subjekti, në mbështetje të këtij deklarimi për të vërtetuar ushtrimin e këtij aktiviteti, ka depozituar deklarata nga disa klientë të përhershëm, të cilët kanë deklaruar se prej vitesh kanë blerë mjaltë dhe produkte të tjera të realizuara nga ferma e gjyshërve.

2.12 Lidhur me të ardhurat e tjera të përfituara nga gjyshërit e subjektit, më konkretisht nga bujqësia dhe blegtoaria, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe referuar shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit së bashku më rezultuan të provuara faktet si në vijim:

- a. me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 20.10.1992, provohet që në emër të shtetasit Z.B është përfituar sipërfaqja 6.000 m² tokë arë;
- b. gjyshi i subjektit, i ndjeri Z.R.B, ka qenë i regjistruar si fermer²¹ në regjistrat fizikë që në vitin 2000;
- c. i ndjeri Z.R.B, prej vitit 2011 është i regjistruar në sistemin informatik “***” me kodin e fermës *** si bletërritës me 51 koshere. Referuar legjislacionit të fushës²², sistemi “***” për herë të parë ka realizuar regjistrimin informatik të fermave në vitin 2011, në bazë të të dhënave të të gjithë fermave blegtorale në Shqipëri, sipas gjendjes faktike të tyre në fundin e vitit 2010.

2.13 Në vlerësimin tim, pasja e një pronësie, sikurse është toka në këtë rast, padyshim krijon hapësirën e përfitimit të fryteve prej saj në formën dhe mënyrën që njeh ligji²³, e cila është

¹⁸Referojuni vërtetimit nr. *** prot., datë 11.2.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë.

¹⁹Referojuni vërtetimit nr. *** prot., datë 17.1.2020, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë.

²⁰Shkresë nr. *** prot, datë 1.3.2022, dërguar me e-mail.

²¹Referojuni vërtetimit nr.*** prot., datë 11.2.2022.

²²Ligjit nr. 8702, datë 1.12.2000, “Mbi sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve” dhe ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

²³Mundësia e krijimit të të ardhurave shihet edhe në koherencë me parashikimet e bëra në legjislacionin civil dhe më konkretisht me parashikimin e bërë në nenin 222 të Kodit Civil në të cilin përcaktohet shprehimisht: *“Pronësia mbi pasurinë*

vlerësuar vetëm në balancimin e shpenzimeve të jetesës së tyre. Nga pikëpamja e përmbushjes së kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës arsyetoj si më poshtë.

2.14 Parë në këndvështrim të analizimit të legjislacionit tatimor, më konkretisht të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve bujqësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët) nuk janë parashikuar si të ardhura të tatueshme. Po ashtu, rezulton se për herë të parë koncepti i fermerit në legjislacionin fiskal është parashikuar në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9848, datë 17.12.2007), aktualisht i shfuqizuar, ku në nenet 58/1, 58/2, 58/3 dhe 58/4 të këtij ligji, përcaktohet skema e kompensimit të fermerëve.

2.15 Referuar këtyre dispozitave vërehet se përfitojnë nga skema e kompensimit fermerët, të cilët nuk janë regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen sipas këtij ligji, por që janë të pajisur me një kod personal të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sikurse provohet në rastin konkret se gjyshi i subjektit ka qenë i pajisur me kodin e fermës *** i regjistruar që prej vitit 2000. Në nenin 58/4 të këtij ligji përcaktohet se është blerësi (personi i tatueshëm) ai që lëshon faturë tatimore për shitësin fermer, për çdo furnizim të marrë prej tij. Në prapësimet e saj, subjekti ka depozituar deklarata noteriale për të konfirmuar faktin se produktet iu janë dhënë klientëve të përhershëm që prej vitesh kanë blerë mjaltë dhe produkte të tjera të realizuara nga ferma e gjyshërve.

2.16 Nga analizimi në harmoni i parashikimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, me parashikimet e bëra në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (cituar më sipër) vërehet se të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore/blegtorale/artizanale që rrjedhin nga aktiviteti i të vetëpunësuarit, si fermer të cilët nuk janë regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen në organin tatimor për periudhën ku pretendohen ligjërimi i këtyre të ardhurave, nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve tatimore.

2.17 Lidhur me pagesën e kontributeve si të vetëpunësuar në bujqësi në nenin 9 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione. Ndërsa, në rregulloren nr. 2, datë 2.12.2008, “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”, përcaktohet se plotësojnë kushtet për t’u siguruar, të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension, sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Sipas dispozitave të mësipërme, të vetëpunësuarit në bujqësi mbartin detyrimin për derdhjen e kontributeve, duke nisur nga moshë 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, pra, sigurimi shoqëror dhe shëndetësor në bujqësi është i detyrueshëm deri në moshën e daljes në pension.

2.18 Në analizë të legjislacionit të përshkruar më sipër, gjykoj se në kushtet që sigurimi shoqëror dhe shëndetësor në bujqësi është i detyrueshëm deri në moshën e daljes në pension, gjyshi i subjektit shtetasi Z.B përjashtohet nga pagesa e sigurimeve si i vetëpunësuar në bujqësi/blegtori. Në çështjen objekt shqyrtimi provohet fakti se z. Z.B ka dalë në pension²⁴ në muajin mars të vitit 1992 dhe, si rrjedhojë, në momentin kur është regjistruar si fermer kishte

e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara kanë kontribuar në krijimin dhe në mbajtjen e ekonomisë bujqësore”, në nenin 227 të Kodit Civil, ku thuhet: “...:(i) ...;(ii) ...; (iii) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes, duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore”.

²⁴Sipas shkresës nr. *** prot., datë 24.3.2022, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Gjirokastrë.

mbushur moshën për pension dhe, për pasojë, nuk ishte i detyruar të paguante sigurime shoqërore.

2.19 Në konkluzion, këto të ardhura bazuar në faktet se: (i) gjyshërit e subjektit kanë jetuar në fshat, pra, shpenzimet²⁵ e tyre të jetesës mbulohen me një pjesë të produkteve bujqësore, blektorale, bletërritjen, si dhe aktivitetin tregtar; (ii) nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë vërtetohet se përfitimi nga parku prej 51 koshere do të ishte rreth 408,000 lekë/vit; (iii) gjyshi i subjektit e dispononte fermën me bletë që prej vitit 2000, duke u provuar kështu që vetëm nga aktiviteti i bletërritjes, specifikisht nga shitja e mjaltit (pa përfshirë të ardhurat nga qumështi i bletëve) mund të ishte përfituar 22.000 lekë/koshere në vit; (iv) kursimet e gjyshërve të subjektit datojnë shumë kohë përpara se subjekti të emërohej në detyrë dhe se shuma e dhuruar ka qenë e depozituar prej kohësh në bankë, prej tyre; (v) të ardhurat e përfituara nga pensioni i tyre nga viti 1991 – 2006 në vlerën 1.057.695 lekë, plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mua si pakicë, në tërësi, më krijojnë bindjen për vlerën reale, si dhe për ligjshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, çmoj se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel provueshmërie dhe besueshmëri të mjaftueshme për të konsideruar si të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua.

2.20 Unë, anëtare në pakicë, kam arritur në këtë konkluzion edhe duke respektuar standardin e njëjtë të mbajtur në çështje me objekt të njëjtë (për të ardhurat nga bujqësia blegtoriale etj., si fermer), ku kam qenë anëtare e trupës gjyqësore në vendimet e formës së prerë respektivisht: nr. ***, datë 22. 4.2021; nr. ***, datë 28.1.2020; nr. ***, datë 16.3.2021; si dhe nr. ***, datë 4.2.2020.

2.21 Në lidhje me barrën e provës, lënë subjektit se *dukej se nuk provohej vlera reale e fitimit të realizuar nga aktiviteti i blegtorisë, nga babai i bashkëshortit të subjektit, të ardhura këto të përdorura si burim për krijimin e shumave 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë dhuruar, nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, B dhe SH.N*, për të cilën shumica në vendim është shprehur se: (i) *për mungesë të të ardhurave ligjore të tyre për të justifikuar shumën e lartpërmendura megjithëse të realizuara përpara bashkëjetesës së djalit të tyre me subjektin dhe para se zonja Bala të ishte subjekt deklarues*; (ii) *...duke e ndërthurur arsyetimin e saj me mosdeklarimet e këtyre shumave në DVP nga të dy bashkëshortët, si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi me të ardhura të prindërve të bashkëshortit, megjithëse të deklaruara në deklaratën Vetting me përshkrimin dhuratë nga prindërit B dhe SH.N 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë të tërhequra nga depozitat e tyre bankare nga kursimet e tyre në vite të depozituara pranë “Raiffeisen Bank”*; (iii) *me argumentin se, (pika 37.3.iii) tërheqja e shumave të sipërpërmendura në total prej 2.022.152 lekësh e nënës së bashkëshortit në datën 15.6.2012 nuk mund të përbëjë provë që këto shuma i janë dhënë bashkëshortit të subjektit për t’i përdorur për blerjen e pasurisë objekt verifikimi..., apo edhe me konkluzionin në rastin kur prindërit e bashkëshortit të subjektit do të justifikonin me të ardhura të ligjshme shumën në total prej 2.022.152 lekësh, mbetet e pavërtetuar që këto shuma janë përdorur për pagesën e çmimit të pasurisë objekt verifikimi, qoftë në datën 8.6.2012, kur janë kryer transfertat bankare në emër të subjektit, qoftë në datën 23.7.2012, kur subjekti pretendon të jetë paguar kësti prej 39.000 euro, arsyetoi si vijon:*

2.22 Fillimisht përpara analizimit të themelit të këtij konstatimi në barrën e provës, shprehem se për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit *se prindërit e bashkëshortit të saj nuk*

²⁵Të cilat konsiderohen për të reduktuar shpenzimet e jetesës, sikurse ka vlerësuar dhe është shprehur Kolegji në vendimin nr. ***, datë 12.7.2021, në pikën 27.2.1., ku thuhet se: “Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar se në pronësi të tij ka tokë bujqësore në të cilën ka kultivuar apo kultivon prodhime bujqësore dhe blegtorale, nëpërmjet së cilës ka ndihmuar apo ndihmon ekonominë familjare, çka, bazuar në pikën 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/201639, rezulton i besueshëm shpjegimi se të ardhurat nga toka bujqësore mund të kenë ndikuar apo ndikojnë në reduktimin e shpenzimeve të jetesës së anëtarëve të saj”.

duhet të konsiderohen persona të lidhur, bashkohem me qëndrimin e shumicës që ky pretendim nuk qëndron, për vetë faktin se dhurimi i tyre ndaj bashkëshortit të subjektit është burim për blerjen e kësaj pasurie dhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm të ardhurat dhe, më tej, në vlerësim të fakteve që dalin, ato çmohen në relevancë të peshës që ato marrin në raport me justifikimin e të ardhurave të ligjshme të këtij burimi të përdorur për blerjen e kësaj pasurie.

2.23 Në vijim, nisur nga fakti që edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një dhurim të përdorur si një prej burimeve të blerjes së pasurisë apartament banimi me sip. 91.09 m², arsyetimi do të bëhet në referim të dy kërkesave që parashikon pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

2.24 Lidhur me vërtetësinë e deklarimeve, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit:

a. Në DPV-në e vitit 2014 (në atë kohë në cilësinë e bashkëjetuesit të saj) ka deklaruar për herë të parë mbi këtë pasuri me përshkrimin: *“Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 12.5.2012, për porositjen e një apartamenti me sip. 91.09 m², në ‘***’, me vlerë të përgjithshme 48.000 euro. Pjesa takuese: 50%”*, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pjesës së tij takuese për këtë pasuri. Sa i përket këtij burimi, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Ky mosdeklarim është konstatuar si fakt nga Komisioni, por për shkak se burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën *Vetting*, peshë i është dhënë provueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të shumave, për të cilat kam arsyetuar më poshtë.

b. Këtë dhurim e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* me përshkrimin *“...dhuratë nga prindërit e mi B dhe SH.N 6.600 (gjashtëmijë e gjashtëqind) euro dhe 1.100.000 (një milion e njëqindmijë) lekë të tërhequra nga depozitat e tyre bankare nga kursimet e tyre në vite të depozituara në Raiffeisen Bank”*. Lidhur me kontributin e prindërve të bashkëshortit, subjekti²⁶ ka depozituar dokumentacion provues për provueshmërinë e tij.

2.25 Edhe në këtë rast, vërehet se dhurimi i përket një lidhjeje të ngushtë familjare (prind-fëmijë) dhe, në vlerësimin tim, ky moment është një faktor i rëndësishëm që krahas provave të administruara dhe analizuara në vijim, përforcon bindjen mbi vërtetësinë e ndodhisë së tij/dhurimit dhe, për pasojë, edhe destinacionit të shumës. Duke ndjekur rrjedhën e deklaramit, më konkretisht, saktësimin e burimit të pasurisë në deklaratën *Vetting* nga të dy bashkëshortët, marrëdhënien e posaçme familjare në dhurimin e kryer, çmoj se subjekti ka deklaruar me vërtetësi burimin e krijimit të pasurisë në fjalë.

2.26 Lidhur me këtë çështje kam arritur në konkluzion, duke ndarë mendim ndryshe nga qëndrimi i shumicës, se për mosdeklarimin e dhurimit nga bashkëshortët në DVP *këto shuma kanë mbetur të pavërtetuara se janë përdorur për pagesën e çmimit të kësaj pasurie*. Për mendimin tim një dyshim i transmetuar në këtë formë nuk është proporcional edhe për sa kohë nuk u provua ndonjë investim tjetër nga asnjë prej palëve dhurues-pranues, apo nuk u identifikua ndonjë devijancë në destinacionin e shumave, përkundrazi u provua ekzistenca e shumave nga punësimet e prindërve, kohë më parë dhurimit, si dhe formalizimi i tyre në sistemin bankar.

2.27 Lidhur me ligjshmërinë e shumës së dhuruar, edhe në këtë çështje, paraqes vlerësimin e provave dhe fakteve të dala nga hetimi dhe procesit në tërësi, si më poshtë:

2.27.i Ka rezultuar se shuma e dhuruar ka qenë e depozituar në bankë nga nëna e bashkëshortit të subjektit shumë kohë përpara kryerjes së dhurimit. Në funksion të provueshmërisë së këtij dhurimi u konstatua e vërtetuar me dokumentacion origjinal dhe të tjerë shumave, lëvizjet bankare,

²⁶Me pyetësorin nr. 4, datë 31.1.2022.

fakte këto të dala nga provat, ku në analizë të tyre lehtësisht vërehet se me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, të institucionit bankar “Raiffeisen Bank” konfirmohet fakti se nëna e bashkëshortit të subjektit, shtetasja SH.N ka çelur një depozitë në këtë bankë në datën 31.8.2006, në vlerën 500.000 lekë dhe 3.000 euro, si dhe në datën 31.3.2008 në vlerat 400.000 lekë dhe 3.000 euro. Kjo shumë në total 900.000 lekë dhe 6.000 euro dhe interesat (përkatësisht 217.149 lekë dhe 630 euro) të përfituara në vite prej tyre provohet se janë tërhequr nga nëna e bashkëshortit të subjektit në datën 15.6.2012, përpara likuidimit të kështit të pagesës së apartamentit në datën 23.7.2012, që do të trajtohet në vijim.

2.28 Nga analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, provohet se të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit kanë qenë të formalizuara, të depozituara në sistemin bankar shumë vite përpara se të kryhej akti i dhurimit, çka mbështet vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të përdorura si burim për blerjen e pasurisë nga subjekti.

2.29 Sa i përket burimit të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit, ndaj mendim ndryshe nga shumica, pasi referuar provave në tërësi të paraqitura nga subjekti, si gjatë hetimit ashtu edhe në parashtrimet e saj, vlerësoj se ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre, bazuar në gjendjen faktike të çështjes, si dhe nën analizën e provave si më poshtë arsyetoj:

i) Ka rezultuar se Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor ***²⁷ ka konfirmuar se të ardhurat e përfituara nga shtetasja SH.N, për periudhën 1993 – mars 2008, janë në shumën 1.832.925 lekë. Përlllogaritja e tyre është kryer deri në mars të vitit 2008, sipas datës së depozitave, sepse këto depozita kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së dhuruar. Gjithashtu, është provuar nëpërmjet librezës së punës se kjo shtetase ka qenë në marrëdhënie pune si infermiere/mami që prej vitit 1983 dhe vijon aktualisht. Nisur nga këto konstatime provohet se këto të ardhura rrjedhin nga burime tërësisht të ligjshme.

ii) Lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i blegtorisë, i ushtruar nga babai i bashkëshortit të subjektit, ka rezultuar se provohen këto fakte: (i) shtetasi B.XH.N ushtron aktivitetin si fermer²⁸, mbarështim të leshta me kod fermeri ***, që prej vitit 1994 dhe në vazhdim dhe ka pasur rreth 100 krerë për çdo vit. Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë ka dhënë informacion edhe mbi përfitimin e mundshëm që mund të realizohet nga ky aktivitet, ku vërtetohet se të ardhurat *neto* vjetore janë në shumën 990.000 lekë; (ii) fermeri²⁹ B.XH.N prej vitit 2005 figuron si fermë blegtorale me 150 krerë të imta dhe nga viti 2011 është i regjistruar në *datbasen* e sistemit “***”, të ARSHVMB-së Vlorë me kodin e fermës me 115 krerë të imta.

2.30 Referuar këtyre provave vërehet se vetëm duke pasur parasysh vlerën minimale të fitimit të llogaritur nga ana e Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, shuma e dhuruar prej 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë nga prindërit do të ishte e mundur të sigurohej si fitim vetëm nga aktiviteti i blegtorisë pa përlllogaritur këtu shumën e të ardhurave nga puna e nënës së bashkëshortit.

2.31 Në vijim të kësaj analize, çmoj se, edhe sikur të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i blegtorisë të kenë shërbyer për shpenzime jetese, vetëm nga të ardhurat nga paga e nënës së bashkëshortit prej 1.832.925 lekësh (të provuara nga dokumente zyrtar shtetëror) mbulohet rreth 90% e shumës së dhënë dhuratë.

²⁷Me vërtetimet e datës 11.2.2022.

²⁸Referojuni vërtetimit nr. *** prot., datë 11.2.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë.

²⁹Referojuni vërtetimit nr. *** prot., datë 17.1.2020, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë.

2.32 Provueshmëria dhe formalizimi i aktivitetit të blegtorisë dhe fakti që ky aktivitet është ushtruar herët nga shtetasi B.XH.N bazohet edhe në kontratat që ka lidhur me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor ***³⁰, kohë pas kohe, të shoqëruara edhe me mandatpagesat të kryera prej tij, ndaj këtij institucioni.

2.33 DRSSh-ja Vlorë³¹ ka konfirmuar se shtetasi B.XH.N figuron i siguar si i vetëpunësuar në bujqësi dhe ka paguar kontribute, për periudhën 1994 – 2005. Po ashtu, ky fakt provohet edhe nga kopja e librezës së kontributeve për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësore të shtetasit B.N, për periudhën 1.1.1994 – 31.8.2006.

2.34 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Pavarësisht faktit që prej vitit 2005 babai i bashkëshortit im ka dalë në pension, prindërit e bashkëshortit ende vijojnë të ushtrojnë aktivitetin si fermerë edhe sot”*.

2.35 Referuar këtij deklarami, që në pikëpamjen time është i besueshëm, provohet fakti se shtetasi B.N ka vijuar të gjenerojë të ardhura nga aktiviteti i blegtorisë.

2.36 Një argument tjetër për t’u evidentuar është edhe momenti i daljes së tij në pension në vitin 2005, që në raport me faktin se depozita në bankë rezulton e çelur në datën 31.8.2006 dhe, më pas, janë bërë derdhje edhe në datën 31.3.2008, na çon drejt analizës që prej tij deri në këto data janë përfituar edhe të ardhura nga pensioni.

2.37 Ka rezultuar se në prapësimet e saj subjekti ka depozituar deklarata, dokument identiteti dhe dokumente mbi ekzistencën dhe objektin e aktivitetit të biznesit të disa shtetasve, për të konfirmuar faktin se ata kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit të mishit dhe se janë furnizuar nga fermeri B.N.

2.38 Nga korrespondenca e Komisionit me “Raiffeisen Bank” u provua se ka depozitime/derdhje shumash, në llogarinë e nënës së bashkëshortit të subjektit³². Këto depozitime datojnë më 24.6.2014 dhe më 10.3.2016, përkatësisht, në shumat 1.000.000 lekë dhe 10.000 euro. Vërehet se secili depozitim ka përshkrimin “nga shitja e bagëtive”, fakt ky që konfirmon deklaramin e institucioneve përkatëse për fitimin e mundshëm të realizuar nga ky lloj aktiviteti dhe, për më tepër, përforcon bindjen se babai i bashkëshortit ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti në blegtori.

2.39 Si një argument plotësues shërben fakti se prindërit e bashkëshortit kanë jetuar në fshat, pra, kanë mundur të sigurojnë produkte bujqësore, si dhe e kanë shfrytëzuar tokën e tyre provuar kjo edhe me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi³³, nr. *** akti, datë 15.6.1999, në emër të shtetasit B.N (babai i bashkëshortit), me të cilin është përfituar një sipërfaqe e konsiderueshme prej 31.000 m² arë në total.

2.40 Në konkluzion, për këto të ardhura, kam çmuar se bazuar në faktet se: (i) prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë jetuar në fshat, pra, shpenzimet e tyre të jetesës mbulohen me një pjesë të produkteve bujqësore dhe blegtorale; (ii) nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë vërtetohet se të ardhurat *neto* vjetore nga aktiviteti i blegtorisë së babait të bashkëshortit janë në shumën 990.000 lekë dhe ushtron aktivitetin si fermer, mbarështim të leshta me kod fermeri ***, që prej vitit 1994 dhe në vazhdim dhe ka pasur rreth 100 krerë për çdo vit; (iii) depozitimi i shumave në bankë me përshkrimin *nga shitja e bagëtive*,

³⁰Kontratë (nuk ka numër) e dhënies në përdorim të kullotave dimërore, datë 16.9.1999, së bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave; kontratë nr. ***, datë 4.7.2000, e dhënies në përdorim të kullotave pyjore, së bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave; kontratë nr. ***, datë 17.7.2000, e dhënies në përdorim të kullotave pyjore, së bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave.

³¹ Shkresë, datë 22.12.2020.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, të “Raiffeisen Bank”.

³³ Depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

rezulton në vlerë të përafërt me fitimin e konkluduar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë; (iv) shuma e dhuruar ka qenë e depozituar në bankë nga nëna e bashkëshortit të subjektit shumë kohë përpara kryerjes së dhurimit; (v) nëna e bashkëshortit të subjektit, që prej vitit 1983 dhe aktualisht punon si **** dhe është konfirmuar se të ardhurat e përfituara prej saj, për periudhën 1993 – mars 2008, janë në shumën 1.832.925 lekë, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, më krijohet bindja për vlerën reale të përfitur, si dhe për ligjshmërinë e tyre, gjithashtu.

2.41 Për rrjedhojë, çmuj se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel provueshmërie dhe besueshmëri të mjaftueshme për të konsideruar të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua nga prindërit e bashkëshortit të saj.

2.42 Në lidhje me konkluzionin e shumicës në pikën 52.2 të vendimit, sa i përket huave të marra nga familjarë të subjektit të rivlerësimit (prindërit dhe motra), shtetasit V.L, ku citohet *...Komisioni krijoi bindjen se huat e pretenduara të dhëna nga shtetasi V.L përkatësisht prindërve dhe motrës së subjektit, nuk kanë shërbyer për pagimin e këstit 39.000 euro në datën 23.7.2012, nuk mbështeten në prova dhe, për këtë shkak, nuk janë evidentuar si barrë prove në rezultatet dërguar subjektit të rivlerësimit.*

2.43 Gjatë hetimit u provua se shtetasi V.L ka pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar dhënien e huave dhe, po ashtu, prindërit dhe motra e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të formalizuara, gjithashtu, në sistemin bankar për të kthyer shumat e marra. Këto janë dy veçori që për mendimin tim mbizotërojnë në provueshmërinë e burimit të krijimit të një pasurie.

2.44 Fakti që veprimet kanë ndodhur brenda të njëjtit vit kalendarik është një tjetër arsye që nuk mund të rëndojë pozitën e subjektit se përse nuk ka deklaruar me rigorozitet se si kanë ndodhur të gjithë veprimet vjetore. Pagesa e këstit të dytë për blerjen e kësaj pasurie e kryer në datën 23.7.2012 është provuar me fakte dhe prova të cilat i arsyetoj në vijim. Për këtë shkak, për sa kohë shumica nuk kundërshton marrjen e huave shtetasit V.L, por apriori, pa provuar të kundërtën, shprehet se shumat e marra hua nuk janë përdorur për këstin e dytë, vlerësoj se ngulmon për të nxjerrë në pah një fakt tërësisht të kontestueshëm, atë të pagesës së shumës së plotë sipas saj, të kësaj pasurie në datën 8.6.2012. Në vlerësimin tim, që shumica të arrinte në këtë konkluzion duhet të rrëzonte mjaftueshëm parashikimet kontraktuale të sipërmarrjes, kryerjen e pagesës së shumës prej 8.000 euro në maj të viti 2012, kryerjen e pagesës së shumës 39.000 euro në korrik të vitit 2012, kryerjen e pagesës së shumës 1.000 euro në vitin 2015, procesverbalin e marrjes në dorëzim të pasurisë në datën 24.7.2012, hapjen e kontratës së energjisë elektrike dhe faturimet e nisura në shtator të vitit 2012, destinacionin e shumave për sa kohë subjekti nuk deklaroi as gjendje *cash*, por edhe shumat e pagesave të cilat janë paguar pikë për pikë, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes, pavarësisht kohës së depozitimit të tyre për arsye të konfirmuara nga subjekti dhe shoqëria si një vullnet i tyre.

2.45 Logjika e përdorur nga shumica, se përse nuk i kishte marrë drejtpërdrejtë subjekti i rivlerësimit këto hua, del jashtë shprehjes së vullnetit të palëve dhe, po ashtu, humbet konceptin e dhurimit. Në rastin në fjalë jemi përpara marrëdhënieve të ngushta familjare dhe nevojës për mbështetje financiare, materializuar nëpërmjet huave, të cilat, për më tepër, janë deklaruar nga subjekti edhe përgjatë hetimit administrativ.

2.46 Kam vlerësuar të mbaj edhe një qëndrim lidhur me shlyerjen e huas në vlerën 1.000.000 lekë të marrë nga subjekti, motrës E.B, po me qëllim blerjen e këtij apartamenti.

2.47 Pavarësisht faktit që ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar këtë hua që në DPV-në e vitit 2012 në rubrikën detyrime financiare dhe, më pas, në DPV-në vitit 2015 dhe në vijim, shumica ka paraqitur argumente se subjekti ka kryer deklarime të pasakta në DPV-të për vitet 2013 dhe

2014, pasi nuk ka deklaruar detyrimin financiar sipas detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar.

2.48 Vlerësoj se ky qëndrim është i pabazuar dhe jo logjik, pasi fakti që nuk është deklaruar në DPV-të për vitet 2013 dhe 2014, nënkupton që nuk ka pasur ndryshime lidhur me këtë detyrim. Argumentet e mia kundërshtojnë arsyet e shumicës për të rënduar pozitën e subjektit, të cilat konkludojnë në këtë pasaktësi dhe jo faktin se sa ajo/pasaktësia qëndron si konstatim. Mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit në këto dy vite (2013 dhe 2014) vërtet mund të jetë një pasaktësi e bërë në deklarimin periodik të atij viti, i cila është ndrequr në vitin 2015 dhe në vijim, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi e identifikuar nga shumica, për vitet 2013 dhe 2014, nuk mund të përbëjë shkak për të analizuar, më tej, përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit.

2.49 Argumentin e shumicës (pika 61.2, paragrafi 2) se... *mungesa e deklarimit të detyrimeve financiare për shkak të huas objekt verifikimi në DPV-të për vitet 2013 dhe 2014, e bëjnë të pabesueshme një harresë të mundshme nga ana e subjektit...dhe nga ana tjetër, i bëjnë të dyshimta deklaratimet dhe veprimet e mëvonshme të subjektit të rivlerësimit* e çmoj si një vlerësim të sforcuar, për më tepër, kur subjekti jo vetëm e ka deklaruar këtë hua të pashlyer në vitet e mëpasshme (2015, 2016 dhe në deklaratën *Vetting*), porse gjatë hetimit ka rezultuar se kjo hua është shlyer në rrugë bankare me transfertat që datojnë në vitet 2018, 2019 dhe 2020, me përshkrimin "*shlyerje huaje*", çka nënkupton se nuk është një fshehje e shlyerjes së këtij detyrimi të pretenduar nga shumica se mund të jetë shlyer në vitet 2013 dhe 2014. Shumica, për t'i dhënë vlerë mosdeklarimit të detyrimit financiar në vitet 2013-2014, hamendëson për një rezultat negativ financiar, pa vendosur shuma konkrete se sa mund të jenë shlyer në secilin vit. Për trupin gjykues kjo çështje nuk është parë si problematike dhe nuk është vlerësuar t'i kërkohe shpjegime subjektit, për sa kohë e ka deklaruar në deklaratat pasardhëse këtë shlyerje, si dhe është provuar shlyerja e saj me transaksion bankar. Ky kërkim nuk është vlerësuar as nga shumica, por hamendësohet në këtë vendimmarrje si një harresë e mundshme nga ana e subjektit.

3. Në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri dhe, specifikisht, mbi çështjen e arkëtimit në BKT të shumës prej 48.000 euro, për llogari të shoqërisë "***" sh.p.k., ndaj mendim të ndryshëm me shumicën për arsyet si më poshtë prezantohen.

Kam çmuar se çështja objekt vlerësimi duhet të bazohet në gjendjen faktike të saj, për të cilën duhet t'u jepet përgjigje/vlerësim katër nënçështjeve specifike në kuptim të ligjit nr. 84/2016,

- i) *çështjes mbi ekzistencën e dyshimeve rreth vërtetësisë së çmimit të paguar prej subjektit, për rrjedhojë identifikimit të vlerës reale të pasurisë apartament banimi, në rast se do të ishte lidhur kontratë me çmim preferencial;*
- ii) *çështjes mbi evidentimin e ndonjë rrethane për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të saj;*
- iii) *çështjes për vlerësimin e transaksionit të kryer në BKT;*
- iv) *çështjes mbi kryerjen e pagesave për këtë pasuri,*

ku pas një vlerësimi të secilës prej tyre veç e veç apo në mënyrë kumulative, të mund të evidentoheshin shkaqet që mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

3.1 Lidhur me çështjen e parë, nga analizimi i fakteve të dala përgjatë procesit, vërehet se subjekti ka qenë konseguente në qëndrimet e saj, referuar deklaratave periodike dhe deklaratës *Vetting*, pasi është konstatuar se:

- i) Subjekti, në deklarimin për herë të parë të kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar: "*Lidhur kontratë sipërmarrje për apartament në vlerën 48.000 euro ...*".

ii) Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit (në atë kohë në cilësinë e bashkëjetuesit të saj) ka deklaruar për herë të parë mbi këtë pasuri, me përshkrimin: *“Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 12.5.2012, për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 91.09 m², në ***, me vlerë të përgjithshme 48.000 euro”*.

iii) Në deklaratën *Vetting*, subjekti dhe bashkëshorti kanë bërë të njëjtin deklaram sa i përket vlerës së apartamentit *“Apartament me sipërfaqe 91.09 m², i ndodhur në ***, apartamenti ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 28.1.2016, e regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. pasurie ***, në bashkëpronësi me bashkëshortin ...”*.

3.2 Ka rezultuar se subjekti ka cilësuar po të njëjtën vlerë për apartamentin objekt i kësaj vendimmarrjeje edhe në përgjigjet e pyetësorëve.

3.3 Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 12.5.2012, kontratës së shitjes³⁴ së pasurisë nr. ***, datë 28.1.2015 dhe kartelës³⁵ bashkëshoqëruese, të pasurisë përcjellë nga ASHK-ja, konfirmohet e njëjta shumë për blerjen e kësaj pasurie.

3.4 Nën krahasimin e të dhënave që përmbajnë dokumentet e sipërcituar, për vlerën e këtij apartamenti me vlerën e parashikuar në çmimet referuese³⁶ të tregut, rezulton se çmimi lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi për vitin 2011, për qytetin e Tiranës, në zonën 4/1 (aty ku ndodhet edhe apartamenti i subjektit është 75.000 lekë/m²). Duke përllogaritur sipërfaqen në metra katror me çmimet referuese, konstatohet se apartamenti është blerë 231.020 lekë më lirë nga vlerat e tregut (6.831.750 – 6.600.730). Kjo diferencë prej 231.020 lekësh, në vlerësimin tim, është e pakonsiderueshme referuar luhatjeve të çmimeve të tregut të pasurive të paluajtshme dhe referuar zonës relativisht larg qendrës së qytetit.

3.5 Përveç sa më sipër, kam çmuar se në këtë çështje kemi të bëjmë me vlerë reale të pasurisë, bazuar edhe në faktet e dala referuar kontratave të ngjashme për pasuri apartament në të njëjtin pallat me subjektin, të vendosura në dispozicion nga ky i fundit dhe shoqëria “****” sh.p.k., ku është konstatuar se të gjitha kontratat ishin përafërsisht me të njëjtat çmime blerje pasurie me njëra-tjetrën dhe me atë të subjektit dhe që në tërësi konkludohet se nuk ka dyshime lidhur me vlerën reale të apartamentit, duke evidentuar këtu edhe faktin që nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të gjendej në ndonjë situatë të konfliktit të interesit.

3.6 Lidhur me çështjen tjetër për evidentimin e ndonjë rrethane për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të saj, nisur nga faktet e dala edhe gjatë hetimit të thelluar të bazuara në moskonfirmimin: (i) nga shoqëria “****” sh.p.k.³⁷ të ndonjë marrëdhënieje kontraktore me subjektin apo familjarë të saj; (ii) nga noterët³⁸ dhe regjistri noterial³⁹ për nënshkrimin e ndonjë marrëdhënieje kontraktore të çdo forme, porosie/sipërmarrjeje me kusht/me rezervë, shitje, etj. me të afërm të subjektit dhe bashkëshortit të saj (motrat dhe vëllezërit e tyre); (iii) nga administratori⁴⁰ i kompleksit “****”, Rruga ***, Tiranë, ku ndodhet pasuria ku banojnë subjekti dhe bashkëshorti, nga lista e plotë e banorëve nuk evidentohet asnjë prej të afërmeve të subjektit dhe bashkëshortit; (iv) nga FSHU-ja⁴¹ dhe UKT-ja⁴² të ndonjë të dhëne për kontrata për shërbime të energjisë elektrike dhe ujësjellës-kanalizime me të afërmit

³⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2020.

³⁵Referojuni Kartelës së Pasurisë së Paluajtshme përcjellë prej institucionit të ASHK-së.

³⁶Sipas Udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”.

³⁷Përgjigje e datës 3.3.2022.

³⁸Përgjigjet e noteres A.H në datën 28.2.2022, notere M.D në datën 28.2.2022 dhe notere M.SH në datën 28.2.2022.

³⁹Përgjigje me nr. *** prot., datë 7.3.2022, e Ministrisë së Drejtësisë, Sektori i Monitorimit të Veprimeve Noteriale.

⁴⁰Përgjigje me nr. *** prot., datë 7.3.2022, e administratorit, hyrë në Komision.

⁴¹Përgjigje nr. *** prot., datë 4.3.2022, e FSHU-së.

⁴²Përgjigje nr. K-*** prot., datë 8.3.2022, e UKT-së.

e subjektit dhe bashkëshortit, në bindjen time dhe në provat e administruara provohet katërcipërsisht se nuk ka dyshime për pasuri të fshehura nga subjekti dhe bashkëshorti, në emër të të afërmeve të tyre.

3.7 Në lidhje me çështjen e radhës për *“transaksionin e kryer në BKT”*, ndaj mendim të kundërt me shumicën, mbështetur në disa argumente që i parashtrij në vijim, të cilat vlerësoj se janë tërësisht të bazuara në provat e administruara gjatë hetimit, përgjigjet e subjektit në pyetësorë dhe prapësime të shoqëruara me provat përkatëse, deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore, deklaratat e përfaqësuesit të shoqërisë *“*****”* sh.p.k., të thirrur si dëshmitar, të analizuar në tërësi dhe në raport me njëra-tjetrën.

3.7.1. Lidhur me transaksionet e kryera në BKT rezultoi se dyshimet e ngritura ishin rrjedhojë e *indicies* dhe informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)⁴³ për raportime transaksionesh të kryera nga subjekti i rivlerësimit në datën 8.6.2012, konkretisht dy depozitime *cash*, njëra në vlerën 33.150 euro dhe tjetra në vlerën 14.850 euro (për këtë derdhje në përshkrim specifikohet qëllimi *“për këtë blerje apartamenti”*), për llogari të shoqërisë *“****”* sh.p.k., në BKT.

3.7.2 Në këndvështrimin tim analiza e kësaj çështjeje, mbi këto dyshime, vlerësohet: (i) sipas dispozitave ligjore të ligjit nr. 9917/2008; (ii) roli dhe sjellja e subjektit me të rënë në dijeni të faktit të kryerjes së transaksionit të të gjithë shumës në bankë, por edhe në raport me gjendjen faktike se si është deklaruar dhe se si janë kryer pagesat e kësaj pasurie nga subjekti; (iii) ligjërimi i shumave të paguara sipas deklaratimeve të subjektit dhe vërtetimeve të nënshkruara mes palëve; (iv) qëndrimi i shoqërisë ndërtimore për faktet e konstatuara; (v) parashikimet kontraktore të bëra mes palëve për përfitimin e kësaj pasurie.

3.7.2.i Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pagesat e kryera në BKT përbëjnë veprime të falsifikuara, rezultoi se prej saj janë ndërmarrë disa hapa konkretë që datojnë që me pyetësorin nr. 3, datë 24.1.2022, ku është pyetur nga Komisioni lidhur me veprimet e pagesave në bankë (të rezultuara në datën 8.6.2012) dhe mospërputhjen me deklaratimet e saj mbi datat dhe mënyrat e pagesave.

3.7.3 Më konkretisht, rezultoi se subjekti ka kërkuar kryerjen e një aktekzaminimi⁴⁴ grafik nga një ekspert i pavarur, të cilin e ka dorëzuar me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ku ekzaminimi grafik ka arritur në konkluzionin se: *“Dy shkrimet dhe dy ‘firmat’ e firmës ‘***’, të shkruara në emër të shtetasës Eriselda Bala në dy dokumentet objekt ekspertimi: Nuk janë shkruar nga asnjëri prej dy shtetasve: Eriselda Bala apo G.J.N. Dy ‘firmat’ që shoqërojnë dy shkrimet me përmbajtje ‘Eriselda Bala’ në dy dokumentet objekt i këtij ekspertimi, janë dukshëm produkte grafike të imitimeve dhe sajimeve grafike”*.

3.7.4 Në vijim të pretendimeve të subjektit se do të ndërmerre hapa konkretë ligjorë për ndjekjen e kësaj çështjeje (deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 24.1.2022), subjekti, në prapësimet datë 30.3.2022, ka deklaruar se ka depozituar kallëzimin penal nr. ***, datë 31.1.2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe se nga ana e kësaj të fundit është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. ***, datë 15.2.2022, për veprat penale *“falsifikim i dokumenteve”* dhe *“shpërdorim i detyrës”*, të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal dhe çështja është ende në hetim. Për të provuar këtë fakt, bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 18.3.2021, të kësaj Prokurorie, nëpërmjet të cilit vërtetohet regjistrimi i procedimit penal.

⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁴⁴Aktekspertimi nr. ***, datë 28.1.2022.

3.7.5 Në datën 1.4.2022, subjekti ka depozituar në Komision kërkesën për dorëzimin e provës shkresore dhe bashkëlidhur saj kopje të akteve⁴⁵ të procedimit penal nr. ***, të vitit 2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

3.7.6 Nga analizimi i këtyre akteve ka rezultuar se në kuadër të këtij procedimi, nga prokurori i çështjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendosur në datën 24.3.2022 kryerja e ekspertimit grafik dhe disa dokumenteve bankare lidhur me dy derdhjet në bankë në emër të subjektit (ekstrakte të printuara nga banka dhe mandatarkëtime të datës 8.6.2012), ndërsa në “aktin e ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit”, nr. ***, datë 30.3.2022, përgatitur nga Instituti i Policisë Shkencore, është arritur në konkluzionin se: *“Shkrimi emër mbiemër ‘Eriselda Bala’ dhe ‘nënshkrimi’ në dokumentet objekt ekspertimi nuk është shkruar dhe nënshkruar nga Eriselda Bala”*.

3.7.7 Sa më sipër, është me rëndësi të evidentohet fakti që subjekti e ka paraqitur kallëzimin penal në një prokurori të ndryshme nga ajo ku ushtronte detyrën, që tregon një prirje të subjektit drejt një hetimi të paanshëm dhe në respektim të legjislacionit procedural penal. E njëjta qasje paanësie vlen edhe për sa i përket aktekspertimit grafik të kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që për më tepër është kërkuar në përputhje me procedurën dhe nga një institucion kompetent siç është Instituti i Policisë Shkencore, që merr fuqinë e provës në një proces penal.

3.7.8 Analiza e shumicës, e cila ka arritur në konkluzion (pika 58.iii) se *dy transfertat bankare të datës 8.6.2012 në emër të subjektit të rivlerësimit ... vërtetojnë kalimin në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., pranë BKT-së, të shumës 48.000 euro*, në mendimin tim ka anashkaluar elemente tepër të rëndësishëm të evidentuar gjatë hetimit të thelluar siç janë: (i) aktekspertimi i nënshkrimit të faturave bankare mbi depozitimet, i bërë nga subjekti menjëherë sapo erdhi në dijeni të faktit të këtyre pagesave nëpërmjet pyetësorit të bërë nga Komisioni, i cili ka arritur në konkluzionin që nënshkrimet nuk ishin të subjektit dhe bashkëshortit të saj; (ii) kallëzimi penal i kryer nga subjekti lidhur me falsifikimin e nënshkrimit (ku çështja vijon të jetë në hetim) dhe aktekspertimi tjetër që ka arritur në të njëjtin konkluzion se firmat nuk i përkisnin subjektit dhe bashkëshortit të saj; (iii) informacioni i shoqërisë ndërtimore i dhënë shkresërisht se pagesat në BKT janë bërë nga përfaqësuesi i shoqërisë për nevoja të saj; (iv) deklaratimet e përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k., të thirrur si dëshmitar, i cili pohoi gjithashtu se pagesat janë bërë nga një përfaqësues i shoqërisë për nevoja të saj dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni mbi këto pagesa, janë fakte të qenësishme që tregojnë se veprimet nuk janë kryer nga subjekti.

3.7.9 Dyshimi i shumicës se përse subjekti nuk kishte kallëzuar edhe shoqërinë ndërtuese për mendimin tim nuk qëndron. Referuar ligjit nr. 9917/2008, cituar më sipër, të cilit i nënshtrohet edhe BKT-ja dhe, më konkretisht, pikës 1/1, të nenit 4/1 të tij parashikohet se: *“Subjektet/bankat verifikojnë se çdo person që pretendon të veprojë në emër të klientit të tyre është i autorizuar për veprimet e kërkuara, si dhe të identifikojë e të verifikojë identitetin e personit të autorizuar”*. Pra, në këtë rast, nëse do të kishte qenë punonjësi i shoqërisë në momentin e arkëtimit në bankë, do të ishte identifikuar si person i autorizuar për veprimin e kërkuar dhe do të kishte firmosur mandatarkëtimin. Përsa kohë kjo nuk ka ndodhur dhe çështja është kallëzuar, i përket organit të akuzës që në përputhje me konkluzionin e akteve të

⁴⁵(i) Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2022 me objekt “kthim përgjigje” e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (ii) shkresë nr. *** prot/P.C., datë 24.3.2022 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan drejtuar Institutit të Policisë Shkencore; (iii) vendim për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit datë 24.3.2022; (iv) deklaratë e ekspertit datë 30.3.2022; (v) shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2022, e Institutit të Policisë Shkencore; (vi) aktekspertimi grafik shkrimi dhe nënshkrimi nr. ***, datë 30.3.2022, i Institutit të Policisë Shkencore.

ekspertimit dhe me hetimit shtesë që mund kryhet në funksion të këtij procedimi, të konkludojë mbi përgjegjësitë penale dhe autorin.

3.7.10 Në vijim të kundërshtimit të argumenteve të shumicës mbi moskallëzimin e shoqërisë “***” sh.p.k. nga subjekti, paraqes qëndrimin tim edhe referuar vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë në interpretim të legjislacionit penal në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket cilësimit “person të cilit i atribuohet vepra penale”, e gjejmë të trajtuar në mënyrë të qartë në vendimin unifikues nr. 3, viti 2002, të Gjykatës së Lartë ku është arsyetuar: Termin “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” e gjejmë në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijeni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi “*person të cilit i atribuohet vepra penale*”, i marrë në kontekstin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, së bashku me momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet me termin “*person ndaj të cilit zhvillohen hetime*” dhe as me termin “*i pandehur*”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistrë vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtetë autor i veprës penale. Nëse vërtetë personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm dhe në përputhje me ligjin arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj te prokurori dhe deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327) evoluon nga “*person të cilit i atribuohet vepra penale*” në “*person ndaj të cilit zhvillohen hetime*” dhe së fundi në “*i pandehur*”, pavarësisht së çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331).

3.7.11 Sa më sipër, në funksion të hetimit të pavarur, të plotë dhe të gjithanshëm të veprës penale, çmoj se rasti është kompetencë e organit të akuzës të provojë akuzën dhe të identifikojë autorët e saj.

3.7.12 Në konkluzion për sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se edhe pse çështja ndodhet ende në hetim, fakti që aktekspertimi i parë grafik është në një linjë dhe ka arritur në të njëjtin konkluzion me aktekspertimin e bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, akte këto të dala nga ekspertë të licencuar dhe institucione kompetente, në përputhje me legjislacionin në këtë fushë, më krijojnë bindjen mbi dyshimin e arsyeshëm që pagesat e kryera në BKT, në datën 8.6.2012, nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj dhe në të njëjtën kohë përforcojnë qëndrimin e mbajtur nga subjekti lidhur me mënyrën dhe datat e pagesave për këtë pasuri. Në funksion të këtij vlerësimi është edhe fakti që shoqëria “***” sh.p.k., në qëndrimin shkresor të mbajtur në korrespondencën me Komisionin, ka argumentuar nëpërmjet mandatpagesave se ato janë bërë në tri këste njësoj siç ka pretenduar edhe subjekti i rivlerësimit, si dhe fakti që përfaqësuesi i shoqërisë, i thirrur si dëshmitar, ka pohuar se pagesat janë bërë nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të këtyre pagesave.

3.7.13 Në pikën 49.5/ii të vendimit, shumica citon se: “*Për rastin konkret, shoqëria ‘***’ sh.p.k. pranoi derdhjen e shumës 48.000 euro nga ana e një punonjësi të shoqërisë në emër të subjektit në qershor të vitit 2012, duke pretenduar se kjo shumë ka qenë me të ardhura të administratorit të shoqërisë dhe për nevoja të shoqërisë, në formën e një huaje që administratori i ka dhënë shoqërisë, të cilën e ka marrë pasi subjekti ka paguar çmimin e shitjes, pretendime të cilat mbeten në nivel deklarativ pasi: (a) nuk vërtetoi veprimin e huadhënies nga ana e administratorit të shoqërisë së shumës 48.000 euro me ndonjë dokument shkresor si bilancin e vitit 2012, ku duhet të ishte pasqyruar veprimi juridik i huamarrjes; (b)*

nuk vërtetoi kthimin e shumës 48.000 administratorit të shoqërisë, pasi blerësit kishin paguar çmimin e shitjes; (c) nuk u vërtetoi raste të tjera të ngjashme në të cilat pagesa e çmimit të shitjes të ishte bërë nga ana e shoqërisë, pa u likuiduar realisht nga ana e palës blerëse. Për më tepër, shoqëria nuk deklaroi emrin e punonjësit që kishte kryer depozitimin e shumës”.

3.7.14 Unë, si pakicë, nuk dakordësohem me këtë arsytim të shumicës, pasi nuk mund të penalizojmë subjektin e rivlerësimit për veprime dhe administrim të brendshëm të shoqërisë ndërtimore. Punonjësja e shoqërisë “****” sh.p.k., e thirrur në cilësinë e dëshmitares pranë Komisionit, në asnjë rast nuk deklaroi se kjo shumë ishte një hua e administratorit të shoqërisë për likuidimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Përkundrazi, pyetjes së bërë asaj gjatë dëshmisë së dhënë se *dhënia e parave mund të ishte një lloj huaje e pronarit*, dëshmitarja ka deklaruar... *Sepse nëqoftëse është një hua nga pronari, ne duhet të llogarisim interesa nga huaja. Muajin tjetër kur klienti sjell fonde, ne duhet ti kthejmë huanë pronarit dhe pastaj ti bëjmë një derdhje për klientin. Janë 4 veprime më shumë që ne i evitojmë duke mos bërë derdhje nga pronari. Kjo është një këshillë e konsulentëve financiarë që pronari të mos bëjë derdhje në llogari të shoqërisë, përndryshe do të jetë nevoja të bëjë një shtesë kapitali po të jetë nevoja që janë të panevojshme në kushtet që klienti likujdon një muaj apo dy muaj më vonë.* Vlerësoj, se ajo që keqinterpretohet është se shpesh herë kompanitë hyjnë në marrëdhënie huamarrjeje të përkohshme me ortakët e tyre për zgjidhje të shpejta likuiditeti, por kjo kurrësi nuk mund t’i vishet subjektit.

3.7.15 Shumica konkludon se nuk u vërtetua veprimi *i huadhënies nga ana e administratorit të shoqërisë së shumës 48.000 euro me ndonjë dokument shkresor si bilancin e vitit 2012, si dhe kthimi i shumës 48.000 administratorit të shoqërisë, pasi blerësit kishin paguar çmimin e shitjes*, konkluzion që për mendimin tim tejkalon hetimin administrativ dhe nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, për më tepër që përfaqësuesi i shoqërisë nuk identifikoi hua të marrë nga shoqëria, por qartësoi situatën në kontekstin e pyetjes së bërë duke treguar në parim se çfarë ndodh në rast të huamarrjeve. Arsytimi i shumicës duket se krijon një marrëdhënie huaje midis subjektit dhe administratorit të shoqërisë, e cila në fakt nuk ka rezultuar dhe nuk është deklaruar/pranuar si e tillë si nga subjekti dhe as nga shoqëria, pasi e kundërta do të kishte pasur vend për hetime të mëtejshme. Për sa kohë që nuk ekziston kjo marrëdhënie huamarrjeje nuk e gjej me vend kërkimin e bilancit të vitit 2012 apo kthimin e shumave pronarit/administratorit të shoqërisë, sepse në këtë proces nuk u hetua shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k., por u hetua për atë sa situatat e paraqitura apo veprimet e kryera lidheshin me hetimin e kryer ndaj subjektit të rivlerësimit.

3.7.16 Në vijim të arsytimit mbi veprimet e kryera në BKT, vlerësoj se fakti që është iniciuar një proces hetimi penal ndaj falsifikimit të provuar tashmë të nënshkrimeve, pikërisht ndaj BKT-së, që ka detyrim ligjor, garantimin e autentifikimit të tyre (referuar argumenteve të shumicës) është shumë domethënëse në këtë rast, pasi cenohet besueshmëria e bankës dhe, për pasojë, besueshmëria dhe vërtetësia e raportimeve të kryera prej saj në DPPPP.

3.7.17. Për më tepër që në prapësime, subjekti ka parashtruar se ka konstatuar që në aplikimin e kryer në bankë është përdorur një fotokopje e ID së subjektit, gjë që bie në kundërshtim me politikën identifikuese të klientëve dhe personave që kryejnë veprime, duke i shtuar këtij arsytimi edhe faktin e provuar se për rastet e tjera të evidentuara që kanë kryer veprime/derdhje në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në atë datë janë administruar kartat ID të individëve të tjerë që rezultojnë të skanuara me ngjyra.

3.7.18 Në vlerësimin tim, kjo praktikë e ndjekur nga banka bie në kundërshtim me parashikimet e pikës 2, të nenit 5⁴⁶, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

3.7.19 Në një këndvështrim tjetër, referuar pikës 10, të nenit 2, të këtij ligji, parashikohet se subjektet e rivlerësimit përfshihen në kategorinë e “personave të ekspozuar politikisht”, për të cilët në zbatim të nenit 8 të tij, bankat duhet të kryenin një sërë veprimesh të tjera në kuadër të “vigjilencës së zgjeruar”, që presupozon një trajtim ndryshe me masa të shtuara, ndërkohë që rezulton që për identifikim të jetë administruar një fotokopje e kartës ID dhe jo dokumenti origjinal.

3.7.20 Gjithashtu, në vijim të këtyre argumenteve merr vlerë edhe dëshmia e përfaqësueses së shoqërisë “***” sh.p.k. se midis bankës dhe shoqërisë kishte një akord/marrëveshje të pashkruar për kryerjen e veprimeve të tilla bankare, deklarim që dëshmon për një vigjilencë të ulët nga ana e bankës. Në gjykimin tim, në asnjë rast nuk mund të pranohet dhe interpretohet kjo mangësi e bankës si përgjegjësi për subjektin.

3.7.21. Për sa kam arsyetuar më sipër, vlerësoj se argumentet e shumicës janë jobindëse, nuk bazohen në prova, por mbështeten në veprime dukshëm të kryera në mënyrë jokorrekte nga banka, jo në përputhje me ligjin, që cenojnë besueshmërinë e saj, por nga ana tjetër mendoj se nuk mund dhe nuk duhet të rëndojnë pozitën e subjektit.

3.7.22. Në këtë çështje që arsyetohet më duhet të evidentoj gjithashtu edhe faktin se problematika të së njëjtës natyrë shfaqen me të njëjtën bankë edhe në dy raste⁴⁷ të tjera të hetimit administrativ të subjekteve të rivlerësimit.

3.7.23. Për sa më sipër, si pakicë arrij në përfundimin se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë ai personi që ka depozituar shumën prej 48.000 euro, për llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., në dy filiale të ndryshme të BKT-së, janë të besueshme.

3.7.24 Në lidhje me mënyrën dhe datat e kryerjes së pagesave nga subjekti i deklaratimit për këtë pasuri, referuar pagesës në bankë, edhe nëse për një moment do të duhej t’i merrnim të mirëqena, sikur të ishin kryer për llogari të subjektit, konstatoj dy veprime të pakontestueshme të provuara ligjërisht: (i) derdhjen e shumës 8.000 euro si këst i parë i cili është kryer me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes në datën 12.5.2012; si dhe (ii) derdhjen e këstit të fundit në shumën 1.000 euro, i cili është paguar në vitin 2015, fakt i deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPV në kohë reale dhe përpos që këto konstatime janë shoqëruar edhe me provueshmërinë e plotë të burimit të ligjshëm të këtyre shumave. Këto fakte të arsyetuara në vijim nga ana ime, por edhe pagesa e kryer më 23.7.2012, e cila është pasojë e diferencës së dy veprimeve të pakontestuara, përveçse provuar ligjërisht, më krijojnë bindjen se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi pagesat për këtë pasuri.

3.7.25 Shumica nuk konsideron por as edhe kundërshton, minimalisht, derdhjen e kryer në vitin 2015 në shumën 1.000 euro, e cila sikurse citova më sipër është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit po në deklaratën e vitit 2015, pra në kohë reale, që në një përlllogaritje të thjeshtë matematikore mbetet për t’u paguar shuma 47.000 euro, shumë e cila lehtësisht duket se nuk rakordon me shumën 48.000 euro e paguar brenda të njëjtës datë në bankë. Shumën 47.000 euro, paguar në vitin 2012, e mbështet plotësisht edhe deklarimi i subjektit në deklaratën për këtë vit, pra i bërë në kohë reale, ku subjekti ka deklaruar ekzaktësisht: “*Lidhur*

⁴⁶“Subjektet pranojnë nga klienti për të marrë të dhëna për të, sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik. Për qëllime të këtij ligji, subjekti mban në dosjen e klientit kopje të vulosura me vulën e subjektit, të dokumenteve të paraqitura nga klienti në formën e mësipërme, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre”.

⁴⁷Referojuni vendimeve nr. ***, datë 3.8.2020 dhe nr. ***, datë 8.4.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit.

me kontratë sipërmarrje për apartament në vlerën 48.000 euro, paguar deri tani 47.000 euro në bashkëpronësi me G.J.N”.

3.7.26 Shumica nuk e konsideron pagesën e kryer në maj të vitit 2012 në vlerën 8.000 euro, e kryer me nënshkrimin e kontratës. Edhe në këtë rast, në një përlllogaritje të thjeshtë matematikore do të thotë që diferenca e mbetur pa paguar do të ishte në vlerën 39.000 euro (48.000 – 8.000 – 1.000 euro), shumë e cila nuk rakordon me pagesën 48.000 euro, depozituar në të njëjtën datë në bankë. Në vlerësimin tim, shuma 8.000 euro është paguar nga subjekti në datën e nënshkrimit të kontratës ashtu sikurse është parashikuar në aktin kontraktor. Shumica i bën një lexim të shkëputur parashikimit kontraktor për këtë pagesë duke e argumentuar: *“Për më tepër, kontrata e porosisë parashikon se shuma 8.000 euro do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate dhe nuk ka parashikuar se kjo shumë është likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate. Lidhëza do të tregon që veprimi do të kryhej në të ardhmen dhe, në këtë rast, vërtetimi i pagesës së kështit prej 8.000 euro do të bëhej i besueshëm nëpërmjet një dokumenti bankar apo një mandatarëkëtimi. Akoma më tej, pretendimi i subjektit mbështetur edhe nga shoqëria se shuma 8.000 euro është likuiduar cash ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, bie në kundërshtim me vetë parashikimin në këtë kontratë, sipas së cilës çmimi i shitjes, duke përfshirë edhe kështin me vlerë 8.000 euro, do të likuidohet në llogarinë bankare të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., si dhe me praktikën e ndjekur dhe orientimin e shoqërisë ndërtimore, e cila kishte paralajmëruar klientët që likuidimi i çmimit të blerjes do të bëhej në rrugë bankare”.*

3.7.27 Janë disa momente për të cilat ndaj mendim ndryshe nga shumica për sa ka argumentuar më sipër.

a. Së pari, kurrsesi nuk mund të zhbëjmë vullnetin e palëve se si ata vendosin parashikimet kontraktore, për më tepër kur akti është noteruar përpara një noteri publik.

b. Në të tilla kushte është mëse e kuptueshme që në një lexim literar⁴⁸ dhe jo të shkëputur të kontratës se *shuma do të likuidohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës* do të thotë që për sa kohë kontrata është nënshkruar në datën 12.5.2015 sikurse shprehet noteri se akti është nënshkruar në prani të tij, automatikisht shuma 8.000 euro merret e mirëqenë e paguar në atë datë. Ky është edhe momenti që përmbys pagesën 48.000 euro në datën 8.6.2012, kryer në dy mandate të nënshkuara nga subjekti i rivlerësimit. Dukshëm, lidhur me kryerjen e kësaj pagese, nuk mbizotëron koha e ardhme, por lidhëza *“do të”*, i përket momentit të nënshkrimit të kontratës, i cili është i lidhur ngushtësisht me datën e hartimit dhe nënshkrimit të aktit nga palët në prezencë të noterit dhe kjo është pikërisht data 12.5.2012.

c. Sigurisht, përveç këtij momenti, është edhe fakti se shumica në asnjë rast nuk konkludoi në një tjetër pasuri në llogari të subjektit, as edhe nuk identifikoi ndonjë fakt që të kundërshtonte pagesën 1.000 euro, kryer për këtë pasuri në janar të vitit 2015.

ç. Shumica, për të arritur në konkluzionin se pagesa është kryer në datën 8.6.2012, i ka qëndruar sistematikisht kontratës së shitjes nr. ***, datë 28.1.2015, duke cituar (pika 50, paragrafi 4) ...: *“Kontrata e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 26.1.2015, parashikon që shitësi deklaron se pronën sa më sipër ia shet blerësit kundrejt shumës 48.000 euro. Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit. Ky deklaram, në këtë*

⁴⁸Ligjvënësi ka përcaktuar në nenin 706 të Kodit Civil se: *“Në shitjen që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, fitimi i pronësisë bëhet sapo sendi ose e drejta pranohet se ekzistojnë”.* Me anë të një kontrate të tillë, palët kanë për qëllim transferimin në të ardhmen të të drejtës së pronësisë. Ky konkluzion arrihet në interpretim të kontratës, sipas nenit 681 të Kodit Civil, i cili përcakton se: *“Kur interpretohet një kontratë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës”.* Fitimi i pronësisë së sendit ose të drejtës në të ardhmen realizohet në rast të plotësimit të dy kushteve që janë: (a) pranimi i ekzistencës së sendit apo i të drejtës; dhe (b) pagimi i çmimit.

kontratë, e cila përbën provë shkresore të pakontestueshme, si dhe fakti që në datën 6.8.2012, është paguar në rrugë bankare shuma 48.000 euro dhe jo shuma 40.000 euro, përforcon bindjen se subjekti nuk e ka paguar realisht shumën 8.000 euro në datën 12.5.2012, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe se vlera e paguar në rrugë bankare në datën 8.6.2012 prej 48.000 euro, ka qenë pikërisht për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, ndonëse derdhja nuk është bërë nga subjekti, por nga ana e një punonjësi të shoqërisë”.

d. Edhe në këtë rast ndaj qëndrim ndryshe me shumicën (për çfarë është cituar nga shumica në germën “ç” në këtë pakicë), duke arsyetuar disa momente të rëndësishme. Së pari, duke e marrë shabllon togefjalëshin *kjo vlerë është likuiduar në favor të shitësit në llogarinë e tij bankare*, çmuj se është arritur në një konkluzion të gabuar. Referuar kontratës së sipërmarrjes datë 12.5.2012, në pikën 4.2 të nenit 4 të saj thuhet shprehimisht: *“Pagesat do të shlyhen në numrin e llogarisë të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., në bankën ‘Societe Generale Albania’”*. Në fakt, shuma 48.000 euro është depozituar në BKT. Konstatohet se kontrata e shitjes nuk identifikon këtë bankë si pritëse të shumës. Dukshëm, gjendemi përpara një diferencimi dhe mospërputhjeje të bankës ku duhej apo ku është derdhur shuma. Pra, llogaria bankare e pacituar në kontratën e shitjes, jo domosdoshmërisht është në BKT, me qëllimin e vetëm për të qenë në funksion të shumës 48.000 euro. Edhe këtë moment shumica nuk e pasqyron dhe, për pasojë, as edhe e argumenton. Gjithashtu nuk dakortësohem edhe me qëndrimin e radhës nga shumica (në pikën 49.5.iii) kur argumentohet se... *Deklarimi i shoqërisë që derdhja e shumës 48.000 euro, në emër të subjektit, ka qenë një lapsus, pasi në fakt duhet të derdhej shuma 40.000 euro, vlerësohet i pavërtetë, referuar kuptimit të mirëfilltë të fjalës lapsus: ... deklarimi se derdhja e kësaj shume ka qenë një lapsus, çmohet të jetë kryer nga ana e shoqërisë për të justifikuar pikërisht derdhjen në total të çmimit të shitjes në vlerën 48.000 euro, në datën 8.6.2012, dhe është një fakt më tepër që tregon se pagesa e shumës 8.000 euro nuk ishte kryer me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, datë 12.5.2012, sikurse subjekti pretendon, pasi në dëshminë apo informacionin e shoqërisë ndërtuese nuk më rezulton të jetë deklaruar një fakt i tillë se duhej të derdhej shuma 40.000 euro, ndërkohë që shoqëria qartazi ka dëshmuar se kjo shumë e derdhur në qershor 2012, nuk i përkiste subjektit të rivlerësimit. Pra, për mua si pakicë edhe ky argument i shumicës është një sforcim i bërë në funksion të pagesës së shumës 48.000 euro të etiketuar domosdoshmërisht si shumë e subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, referuar kontratës së shitjes ardhur nga ASHK-ja dhe administruar nga Komisioni, thuhet se kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit sipas kontratës së sipërmarrjes bashkëlidhur. Në vlerësimin tim, për sa kohë gjendemi përpara një akti noterial me të njëjtat të dhëna të regjistrimit të tij, për sa kohë nuk kemi administruar kontestime nga palët nënshkruese, pavlefshmëri apo korrigjime të aktit, sikurse parasheh ligji për noterinë apo legjislacioni civil në tërësi, atëherë sërish roli dhe përgjegjësia e noterit që presupozohet se ka lexuar aktin me zë⁴⁹, nuk mund t’i vishet në ngarkim subjektit dhe ta ndëshkojë atë me pa të drejtë. Në gjykimin tim, me shumë gjasë subjekti nëse do të kish rënë në dijeni të faktit të parashikimit të ndryshëm nga njëra kontratë shitje në tjerën, lidhur me mënyrën e pagesës së apartamentit, do të kish kryer veprimet e nevojshme për korrigjimin e aktit, çka tregon se subjekti ka nënshkruar aktin duke vepruar në mirëbesim të plotë përballë noterit publik i cili është garanti i përpilimit të aktit në mënyrë të pastër, qartë dhe në përputhje me ligjin⁵⁰. Edhe nëse pala do të kërkonte të hartoheshin dy akte me thënie të ndryshme apo kontradiktore për qëllime dhe arsye të paditura, noterit në*

⁴⁹ Sipas nenit 49 të ligjit nr.7829/1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar (në atë kohë në fuqi) ku ndër të tjera thuhet...” Akti noterial hartohet nga noterit në prani të palëve. Akti noterial duhet të përmbajë: ë) faktin se noterit ua lexoi e u shpjegoi aktin palëve dhe deklarimet e tyre se e kanë kuptuar dhe e pranojnë atë, si dhe faktin e vënies së nënshkrimeve në prani të noterit;”

⁵⁰ Duke përmbushur ndër të tjera detyrimin e parashikuar në nenin 43 të ligjit nr.7829/1994, “Për Noterinë” i ndryshuar (në atë kohë në fuqi), ku thuhet “Aktet noteriale duhet të redaktohen pastër, qartë dhe në mënyrë që të mos lënë vend për moskuptime e keqinterpretime.”

përmbushje të kompetencave ligjore⁵¹ që i njej ligja, kurrësesi nuk mund të vërtetohet përmbajtje të ndryshme në të njëjtat numra repertori dhe koleksioni. Logjika e kundërt e këtyre dy argumenteve më sipër do të qëndronte vetëm në rastin e një hetimi të mëtejshëm nëse do të prezantohej ndonjë e dhënë apo indicie tjetër, që në rastin konkret nuk ekzistoi.

dh. Si pakicë pasqyrova momente që impaktojnë konkluzionin e kësaj vendimmarrjeje për të vijuar me pozitën e subjektit të rivlerësimit lidhur me nënshkrimin e saj në dy mandatet bankare dhe pozicionin e bankës në cilësinë e të kallëzuarit që, për mendimin tim, bazohet thelbësisht në ligjin nr. 9917/2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. - Referuar pikës 10, të nenit 2 të këtij ligji, subjektet e rivlerësimit përfshihen në kategorinë e “Personave të ekspozuar politikisht”, për të cilët në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, bankat duhet të kryenin një sërë veprimesh të tjera në kuadër të “vigjilencës së zgjeruar”, që presupozon një trajtim ndryshe me masa të shtuara ndërkohë që rezultojnë për identifikim të jetë administruar një fotokopje e kartës ID dhe jo dokumenti origjinal.

- Sipas nenit 22/1 të Ligjit të lartpërmendur, parashikohet se, “Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPPP-ja për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale”. Në referim të kësaj baze ligjore, vlerësoj se për sa kohë që informacioni i DPPPP-së nuk përbën provë në një procedim penal, kjo do të thotë se dyshimi mbi një transaksion duhet t'i nënshtrohet një hetimi të thellë, që për rastin tonë objekt shqyrtimi, për subjektin nuk është evidentuar ndonjë urdhër⁵² i DPPPP-së, për monitorim si rast i dyshimtë për pastrim parash, sipas parashikimit të gërmës “I”⁵³ të nenit 22 të këtij ligji.

e. Më konkretisht, gjatë hetimit administrativ u konstatua se subjekti i rivlerësimit me të rënë në dijeni të mandateve bankare të nënshkruara nga ana e saj, paraqiti shpjegimet si dhe depozitoi aktekspertimin, i cili konkludonte në mënyrë të prerë se nënshkrimi nuk ishte i saj.

ë. Në mendimin tim vlerësimi i shumicës (në pikën 46) se... *Komisioni nuk e ka vënë në diskutim ndonjëherë këtë fakt dhe, për rrjedhojë, nuk ka vënë në dyshim rezultatin e aktit të ekzaminimit grafik nr. 3, datë 28.1.2022, sipas të cilit, dy shkrimet dhe nënshkrimet në emër të shtetases Eriselda Bala në dy dokumentet objekt ekspertimi nuk janë shkruar nga asnjëri prej dy shtetasve Eriselda Bala apo G.J.N. Ky fakt u vërtetua nga informacioni i paraqitur nga shoqëria “***” sh.p.k., e cila, në të gjitha komunikimet që ka pasur me Komisionin, qoftë nëpërmjet akteve shkresore, qoftë nëpërmjet deklarimeve të përfaqësueses së saj përpara Komisionit, ka pranuar që kjo shumë është derdhur në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k. nga një punonjës i saj, pra jo nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj. Në këto kushte, këmbëngulja e subjektit se nënshkrimi në aktet bankare nuk është i saj apo i bashkëshortit të saj dhe, si i tillë, duhet të konsiderohet nul nga Komisioni, vlerësohet i panevojshëm, për sa kohë shoqëria e pranoi këtë fakt dhe, për më tepër, ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me pagesat dhe shkaku e kryerjes së tyre, dhe pastaj arsyetimi po i shumicës ... në lidhje me dy aktet shkresore të titulluara mandatarkëtim, apo me mënyrën se si subjekti ka siguruar shumën 39.000 euro në datën 23.7.2012, kur pretendon të jetë likuiduar pjesa më e madhe e çmimit të shitjes, përforcojnë bindjen se ka qenë subjekti që ka autorizuar depozitimin në rrugë bankare të shumës prej 48.000 euro në datën 8.6.2012, fakt i pranuar edhe në kontratën e shitjes së pasurisë, sipas së cilës çmimi i shitjes është paguar në llogarinë bankare të palës shitëse, në një kohë që kallëzimi penal është ende në procedurë e sipër, është kontradiktor për sa kohë, nga njëra anë nuk vihet në dyshim konkluzioni i aktit të ekspertimit nga shumica, dhe nga ana tjetër*

⁵¹ P.sh. përkundër, sipas nenit 41 të ligjit nr.7829/1.06.1994, “Për Noterinë” i ndryshuar (në atë kohë në fuqi) thuhet se “Noteri refuzon redaktimin e çdo akti, përmbajtja e të cilit bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit.”

⁵² Në gjendjen faktike të provave të administruara në dosje.

⁵³ “I) urdhëron, kur ka arsye të bazuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi, monitorimin, gjatë një periudhe të caktuar të veprimeve bankare që janë duke u kryer përmes një ose më shumë llogarish të përcaktuara”.

përforcohet bindja (e tyre/shumicës) *se ka qenë subjekti që ka autorizuar depozitim në rrugë bankare të shumës*, duke e lidhur këtë moment, në gjithë morinë e provave dhe rrethanave të pakontestueshme, me kontratën e shitjes për të cilën kam arsyetuar gjerësisht në këtë pakicë.

f. Për sa kohë kam ndarë mendim ndryshe lidhur me kryerjen e pagesës për këtë pasuri duke u bindur mbi bazë faktesh dhe provash se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi pagesat e kryera dhe se nuk ka depozituar edhe në bankë shumën 48.000 euro, arsyetoj në vijim lidhur me pagesat e kryera sipas deklarimit të subjektit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

g. Së pari, përgjatë hetimit administrativ kam vërejtur se subjekti ka qenë konsistent në qëndrimet e saj lidhur me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie, referuar deklarimeve periodike (ku në deklaratën periodike të vitit 2012, ka deklaruar se ka paguar 47.000 euro dhe në deklaratën e vitit 2015 ka deklaruar pagesën e diferencës prej 1.000 euro), përgjigjet e dhëna gjatë hetimit (ku subjekti ka sqaruar⁵⁴ se likuidimet e kësaj pasurie janë kryer sipas një rendi kronologjik të caktuar): (i) 8.000 euro, në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë 12.5.2012; (ii) 39.000 euro në datën 23.7.2012 sipas mandatarkëtimit; dhe (iii) 1.000 euro në datën 5.1.2015, të mbështetura në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 12.5.2012 dhe kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.1.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe mandatpagesat e nënshkruara nga të dyja palët, të depozituara nga vetë subjekti, por edhe nga shoqëria “****” sh.p.k.

gj. Kalendarin e pagesave, i pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes, ka ndryshuar vetëm afatin kohor të këstit të dytë dhe të tretë por jo vlerat, pra ato janë në përputhje të plotë me shumën e depozituara pranë shoqërisë sipas vërtetimeve të nënshkruara nga të dyja palët shitëse dhe blerëse. Lidhur me këtë, jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵⁵ e ka trajtuar këtë çështje dhe ka konkluduar *se këto afate mund të konsiderohen si orientuese për palët nënshkruese dhe nuk kanë fuqinë e provueshmërisë së këtij kalendar për shlyerjen e shumave, për sa kohë flitet për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen. Sigurisht që palët udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të ushtrojnë të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët.*

h. Sipas kontratës së sipërmarrjes ishte parashikuar se dorëzimi i çelësave të apartamentit do të bëhej në momentin e pagesës së këstit të dytë në shumën 39.000 euro. Fakti që kalendarin e pagesave është orientues, pra jo domosdoshmërisht i zbatuar në mënyrë strikte, fakti që shuma 8.000 euro, në vlerësimin tim ligjor dhe provues, është paguar me nënshkrimin e kontratës, që shuma 1.000 euro është paguar në janar të vitit 2015, fakti që vërtetimet e pagesave nuk janë të njëanshme por janë nënshkruar nga të dyja palët kontraktore, fakti që minimalisht shumën e depozituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në këstin e dytë në favor të kësaj pasurie janë siguruar nga tërheqje bankare (sikurse do arsyetoj në vijim lidhur me ligjshmërinë e tyre) pas datës 8.6.2012, më krijojnë bindjen e plotë se shuma 39.000 euro është depozituar në korrik të vitit 2012. Vlerësimi im përforcohet edhe me faktin se subjekti dhe shoqëria kanë mbajtur procesverbalin përkatës në datën 24.7.2012 për të identifikuar marrjen në dorëzim të çelësave të apartamentit, veprimi i cili së bashku me të gjitha argumentet dhe provat e lartpërmendura plotësohet edhe me faktin se nga korrespondenca me FSHU-në⁵⁶ është konfirmuar se për kontratën e furnizimit me energji elektrike nr. ***, në emër të bashkëshortit të subjektit, në Rrugën *** në instancën Tiranë, referuar tabelës së treguesit të pagesave mujore nga muaji shkurt 2012 deri në muajin gusht 2012, janë paguar tarifa mirëmbajtjeje/shërbimi (që varion

⁵⁴Pyetësor nr. 2, datë 6.12.2021.

⁵⁵Referuar vendimit nr. ***, datë 31.7.2019.

⁵⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

në vlerat 118.48 lekë – 640 lekë⁵⁷), ndërsa fillimi i pagesave të mirëfillta të energjisë është muaji shtator i vitit 2012, ku edhe rezultoi të ketë filluar të konsumohet energji elektrike.

3.8. Duke ndjekur kronologjinë e arsytimit, si dhe konstatimet e deritashme, rrjedhimisht ndaj mendim ndryshe edhe lidhur me pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, si dhe aftësinë paguese të tyre. Në këtë kontekst kam vlerësuar të argumentoj në mënyrë më të detajuar secilën prej pagesave/kësteve të kryera për pasurinë objekt i këtij hetimi administrativ.

3.8.1. Në lidhje me këstin e parë në shumën 8.000 euro

i) Sa i përket pagesës së këstit të parë është e provuar që është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes, e cila në nenin 4 parashikon specifikisht se: *“Kësti I në shumën 8.000 euro do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate, siç është rënë dakord mes palëve”* dhe mbështetet në deklaratimet e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit.

ii) Ndryshe nga vlerësimi “hipotetik” i shumicës, e cila ngre dyshime mbi aftësinë paguese të subjektit për këstin e parë prej 8.000 euro, duke e vlerësuar atë sikur të ishte paguar në datën 8.6.2012, ndaj mendim ndryshe pasi:

- a) është provuar që subjekti i kishte të ardhurat në depozitë dhe mund t’i tërhiqte në çdo kohë, çka provon aftësinë paguese të saj; dhe se
- b) është provuar se pagesat janë bërë sipas rendit kronologjik, ku 8.000 euro janë paguar menjëherë me firmosjen e kontratës së sipërmarrjes dhe kësti i dytë në korrik, që mbështetet nga “mandatarkëtimi” për likuidimin përfundimtar të detyrimit në vlerën 39.000 euro, në datën 23.7.2012, procesverbali i dorëzimit të çelësave në datën 24.7.2012 dhe pagesa e fundit prej 1.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së apartamentit.

iii) Vlerësoj se këto fakte janë në përputhje të plotë me deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*, me mënyrën e shlyerjes së pagesave dhe detyrimeve ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, përgjigjeve shkresore të shoqërisë dhe mandatpagesave të depozituara.

iv) Është provuar se lidhur me pagesën e këstit të parë prej 8.000 euro nuk ka asnjë kundërshtim midis palëve, asaj shitëse dhe palës blerëse.

v) Gjithashtu, është fakt se në momentin e pagesës nuk është vënë në diskutim mundësia financiare e palës blerëse.

vi) Nuk dakordësohem me qëndrimin e shumicës (pika 50, paragrafi 4) *se vërtetimi i pagesës së këstit prej 8.000 euro do të bëhet i besueshëm nëpërmjet një dokumenti bankar apo një mandatarkëtimi*, pasi edhe kontrata e sipërmarrjes, në këtë rast, ka fuqi ligjore dhe i angazhon palët në kryerjen e detyrimeve të ndërsjella, për më tepër që është nënshkruar nga të dyja palët, nga përfaqësuesja e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjekti me bashkëshortin. Pagesa jo vetëm nuk është kundërshtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., por kjo e fundit ka pohuar të njëjtën gjë me subjektin në këtë drejtim.

vii) Shoqëria “****” sh.p.k., në përgjigjen e datës 20.12.2021, përveçse ka shpjeguar se si parashikohej mënyra e pagesës nga palët sipas kontratës së sipërmarrjes, ka saktësuar dhe ka pranuar se si është bërë realisht pagesa e çdo kësti, ku sa i përket vlerës prej 8.000 euro është shprehur: *“Kjo shumë që përbën likuidimin e këstit të parë është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe nuk është lëshuar mandatpagesë meqë është bërë në të njëjtin moment me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes dhe shërbeu si pagesë për rezervimin e apartamentit me kod ***”*.

⁵⁷Referuar vendimit nr. 100, datë 15.2.2009, të ERE “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën janar - dhjetor 2010”, i ndryshuar në vitin 2014.

3.8.2 Në lidhje me këstin e dytë në shumën 39.000 euro

i) Ka rezultuar se në ndryshim nga parashikimet e kontratës së sipërmarrjes, e cila parashikonte specifikisht se *“Kësti II në shumën 39.000 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës (brenda muajit qershor 2012)”*, ai është paguar më 23.7.2012 sipas mandatarkëtimit të nënshkruar nga të dyja palët dhe sipas deklarimeve të subjektit dhe shoqërisë *“****” sh.p.k.*

ii) PAGESA E KËSTIT TË DYTË PROVOHET MË SË MIRI EDHE NËPËRMJET *“procesverbalit të dorëzimit të çelësave më 24.7.2012”* (një ditë pas pagimit të këstit të dytë), pra në kohë reale dhe, gjithashtu, mbështetet edhe në deklaratimet periodike të subjektit.

iii) SHOQËRIA *“****” sh.p.k.*, në përgjigjen e datës 20.12.2021, përveçse ka shpjeguar se si parashikohej mënyra e pagesës nga palët sipas kontratës së sipërmarrjes ka saktësuar dhe ka pranuar se si është bërë realisht pagesa e çdo kësti, ku sa i përket vlerës prej 39.000 euro është shprehur: *“Kjo shumë është likuiduar në fakt në datën 23.7.2012 (sipas mandatit bashkëlidhur)”*.

iv) Edhe përfaqësuesja e shoqërisë në dëshminë e saj ka pohuar se subjekti ka kërkuar një shtyrje të pagesës së këstit të dytë, fakt i cili pohohet edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 6.12.2021, si në vijim: *“Çmuj me rëndësi t’ju sqaroj se kontributi i prindërve të mi dhe motrës sime E.B për blerjen e apartamentit janë bërë në kohë reale, pra në muajin korrik kur unë kisha nevojë. Në atë kohë, në fillim, u vendos nga unë dhe bashkëshorti (atë kohë i fejuari) që t’i kërkonim shoqërisë sipërmarrëse një shtyrje të afatit të kësteve por prindërit dhe motra menduan që të na ndihmonin duke kërkuar një ndihmë të përkohshme hallës dhe bashkëshortit të saj. Për këtë kanë huazuar një shumë parash prej shtetasit V.L (bashkëshorti i hallës), deri në maturimin e depozitave të tyre me afat. Me tërheqjen e depozitave të tyre bankare, ato i janë kthyer bashkëshortit të hallës”*. Në vlerësimin tim, nisur nga deklarimi i palëve më sipër, analizimi i shumicës se subjekti, pa deklaruar në parashtrime shkakun përse nuk është respektuar afati i kontratës së sipërmarrjes për likuidimin e këstit prej 39.000 euro brenda qershorit të vitit 2012, vijon të mbajë qëndrimin se kjo pagesë është kryer më 23.7.2012, nuk qëndron, për sa kohë ky konstatim nuk i është lënë subjektit në barrë prove.

v) NUK PAJTOHEM ME SHUMICËN KUR KONKLUDON NË LIDHJE ME FORMATIN E MANDATARKËTIMEVE TË PAGESAVE TË KRYERA NGA SUBJEKTI NË FAVOR TË SHOQËRISË NËDËRTIMORE APO EDHE ME KOHËN E DEPOZITIMIT TË TYRE. MË KONKRETISHT, NË VENDIMIN E SAJ (pika 50, paragrafi 3), shumica shprehet: *“Pavarësisht titullimit mandatarkëtimi konstatohet lehtësisht se këto akte shkrësore nuk janë mandatarkëtime të mirëfillta me numër serie dhe në formatin e njohur të tyre, por dy shkresa të printuara dhe të nënshkruara nga shoqëria në datat 23.7.2012 dhe 5.1.2015. Për më tepër, këto dy pagesa nuk janë deklaruar dhe paraqitur nga subjekti në asnjë prej DPV-ve dhe as në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës Vetting, kur subjekti ka paraqitur një numër të konsiderueshëm dokumentesh për të vërtetuar pretendimet e saj, por janë paraqitur për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit”*.

vi) NË VLERËSIMIN TIM, SHPREHJA E VULLNETIT TË PALËVE NË NJË FORMAT TË NDRYSHËM NGA AI I MANDATARKËTIMEVE, PËR SA KOHË NUK PASQYRON NJËANSHMËRI NË NËNSHKRIME DHE MBAN VULËN E SHOQËRISË, PARË EDHE NË HARMONI ME TË GJITHË PROVAT DHE KONSTATIMET SE SI NË FAKT JANË PAGUAR KËSTET E PASURISË, PËR TË CILAT GJITHASHTU U PROVUA EDHE BURIMI I LIGJSHËM I KRIJIMIT TË TYRE, JANË PROVA TË PAKONTËSTUARA DHE SHKOJNË NË FAVOR TË SUBJEKTI TË RIVLERËSIMIT. PËR MË TEPËR, MANDATARKËTIMET NUK JANË KONTËSTUAR NË ASNJË MOMENT NGA KOMISIONI DHE AS JANË LËNË SI BARRË PROVE PËR SUBJEKTIN NË REZULTATET E HETIMEVE, PASI ATO NUK REZULTUAN TË ARDHURA NË KUNDËRSHTIM ME DEKLARIME APO NDONJË PROVË TË ADMINISTRUAR PËRGJATË PROCESIT TË KËTIJ HETIMI ADMINISTRATIV.

Gjithashtu, referuar dëshmisë së përfaqësueses së shoqërisë “****” sh.p.k. dhe korrespondencës me këtë shoqëri u provua ekzistenca e tyre.

3.8.3. Në lidhje me këstin e tretë në shumën 1.000 euro

i) Ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar pagimin e këstit të tretë prej 1.000 euro në DPV-në e vitit 2015, me përshkrimin “Apartamenti në bashkëpronësi me bashkëshortin/bashkëjetuesin GJ.N me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 12.5.2012, i deklaruar edhe në deklaratimet e mëparshme, është paguar kësti i fundit prej 1.000 euro dhe është lidhur kontrata e shitjes. Bashkëlidhur kopje të certifikatës së pronësisë. Vlera e paguar: 1.000 euro. Pjesa takuese: 50%”.

ii) Të njëjtin deklaratim ka bërë edhe bashkëshorti i subjektit, shtetasi GJ.N, në DPV-në e vitit 2015, por duke shtuar paragrafin me përshkrimin “Pakësuar shuma prej 300.000 lekësh, gjendje *cash* në shtëpi. Janë përdorur për pagesën e këstit prej 1.000 euro për blerjen e shtëpisë dhe për procedurat e hipotekimit. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

iii) Gjatë hetimit, Komisionit në analizën financiare të kryer për vitin 2014 nuk i kanë rezultuar problematika në krijimin e kursimeve *cash* dhe as në vitin 2015 kur ato janë përdorur.

iv) Në kontratën e sipërmarrjes⁵⁸ nr. ***, datë 12.5.2012, mënyra e likuidimit të këstit të tretë është parashikuar specifikisht “kësti i tretë në shumën 1.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit”⁵⁹ dhe në fakt ky veprim ka rezultuar i kryer në vitin 2015, kur dhe është formalizuar kontrata e shitjes.

v) Gjatë hetimit subjekti ka sqaruar⁶⁰ se likuidimi i këstit të tretë të kësaj pasurie është kryer më 5.1.2015, sipas mandatarkëtimit.

vi) Sa më sipër, lidhur me pagesën e këstit të tretë prej 1.000 euro, çmuj se është tashmë e provuar shlyerja e tij nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në datën 5.1.2015.

vii) Shoqëria “****” sh.p.k., në përgjigjen e datës 20.12.2021, përveçse ka shpjeguar se si parashikohet mënyra e pagesës nga palët sipas kontratës së sipërmarrjes, ka saktësuar dhe ka pranuar se si është bërë realisht pagesa e çdo kësti, ku sa i përket vlerës prej 1.000 euro është shprehur: “*Kjo shumë është likuiduar në fakt në datën 5.1.2015 (sipas mandatit bashkëlidhur)*”.

viii) Tashmë, nisur nga faktet e provuara se: (a) depozita në emrin e subjektit pranë “Credins Bank” në shumën 1.438.000 lekë është tërhequr nga llogaria më 22.6.2012; (b) depozitat bankare të prindërve të bashkëshortit, në shumat 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, janë tërhequr më 15.6.2012; si dhe (c) nga llogaria bankare e bashkëshortit të subjektit është tërhequr shuma prej 4.000 USD më 20.7.2012, qartësisht duket se subjekti nuk kishte mundësi ta shlyente këstin e dytë në datën 8.6.2012. Sikurse vërehet, këto tërheqje datojnë pas datës 8.6.2012, kohë që përputhet plotësisht me deklaratimin e subjektit se kësti i dytë është paguar në datën 23.7.2012, fakt ky i konfirmuar si nga shoqëria “****” sh.p.k. edhe nga dokumentacioni mbështetës, përkatësisht mandatarkëtimi datë 23.7.2012, datë kjo që plotëson kushtin e kontratës mbi pagesën e dytë të çmimit të kësaj pasurie “me dorëzimin e çelësave”.

4. Lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave të subjektit dhe analizën financiare

4.1 Nga analiza financiare, e kryer në raport me momentet e kryerjes së pagesave, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e tyre, në raport me burimet e

⁵⁸Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 1, datë 9.1.2020, nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2020, si dhe nga shoqëria “****” sh.p.k. më datë 20.12.2021.

⁵⁹Sipas parashikimit në nenin 4, pika 4/1/c e kontratës së sipërmarrjes.

⁶⁰Pyetësor nr. 2, datë 6.12.2021.

ligjshme të deklaruara prej saj, të analizuar më sipër. Në këtë këndvështrim vlerësoj se për sa kohë që shumica nuk ka mundur të evidentojë asnjë provë për të provuar të kundërtën, nuk mund të rëndohet pozita e subjektit të rivlerësimit duke përfshirë në analizë bërjen e pagesave për të njëjtën pronë dy herë, me bankë dhe *cash*, në vlerën totale prej 96.000 euro, që referuar zonës ku ndodhet pasuria apartament edhe në çmimet aktuale ka një vlerë tregu më të vogël, jo më referuar çmimeve në vitin 2012. Këtë qëndrim e kam mbajtur që në fazën e mbylljes së rezultateve në vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 15.3.2022, pasi kam ndarë mendim ndryshe me qëndrimin e shumicës, që për mua duket të jetë absurd, kur nga njëra anë trupi gjykues ka pranuar se nuk ka dyshime për vlerën reale të blerjes së këtij apartamenti në shumën 48.000 dhe nga ana tjetër konkludonte duke përfshirë në analizë financiare të njëjtën pagesë dy herë, pra, 96.000 euro.

4.2 Në konkluzion, për sa kam arsyetuar më sipër, analiza e re financiare duke përfshirë të ardhurat e ligjshme nga gjyshërit e subjektit dhe prindërit e bashkëshortit, si dhe duke i qëndruar vlerës 48.000 euro për pasurinë apartament sipas planit 8.000 euro datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes (12.5.2012), 39.000 euro më 23.7.2012 dhe 1.000 euro në vitin 2015 rezultojnë pozitive si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2011	23.7.2012
1	TË ARDHURA	1,926,649	5,009,728
	Të ardhura nga paga subjekti	924,630	526,443
	Të ardhura nga paga bashkëshorti		424,441
	Dhurim nga gjyshërit me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 25.11.2011	1,000,000	
	Hua E.B (motra) 2012 (1.000.000 lekë)		1,000,000
	Dhuratë nga prindërit për blerje apartamenti 1.000.000 lekë		1,000,000
	Të ardhura nga interesat	2,019	36,693
	Dhurim nga prindërit e bashkëshortit (6.600 euro dhe 1.100.000 lekë)		2,022,152
2	SHPENZIME	340,005	206,528
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	136,620	164,528
	Shpenzime qiraje	72,000	42,000
	Shpenzime sipas sistemit <i>TIMS</i>	131,385	
3	PASURI	1,399,475	4,154,851
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Apartament me sip. 91.09 m ²		6,460,620
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,399,475</i>	<i>(2,305,769)</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	187,170	648,350

4.3 Sa i përket konkluzioneve të shumicës lidhur me deklaratime të pasakta në pikën 68 të vendimit, vlerësoj se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklaratime të rreme. Gjithashtu, subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit.

4.4 Për rrjedhojë, mbështetur edhe në praktikën e Kolegjit⁶¹, vlerësoj se për sa kohë që deklaratimet e pasakta të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar të gjitha shpenzimet dhe pasuritë e krijuara në vite, nuk mund të konsiderohen se janë rrethana të mjaftueshme për të shkarkuar subjektin.

VLERËSIMI TËRËSOR

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, unë, si anëtare/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të kushtetutës dhe në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, subjekti i rivlerësimit duhet të ishte konfirmuar në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që nuk ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala, nuk është i drejtë, pasi ka përmbushur edhe kushtin e pikës 1/a, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Për arsyet e sipërcituara, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1/a dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit arrin nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe në kushtet e përmbushjes së nivelit të besueshëm edhe për dy kriteret e tjera, gjykoj se shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin e saj në detyrë.

Brunilda BEKTESHI
Anëtare (kundër)

⁶¹Në vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 10/2018, nr. 12/2018, nr. 9/2019, nr. 28, datë 23.10.2020, dhe nr. 2, datë 15.2.2022.